

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7665 E shtunë 29 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**  
Profesor Shezai Rrokaj, përmes një shkrimi të gjatë, botuar pak ditë më parë, publikoi konstatimet e tij për digitalizimin si mjet në dobi të përmirësimit...  
Vijon në faqen 20

Nga PËLLUMB KARAMETA  
Kuptimi i ndryshimit në arsim ndihmon edhe digitalizimin e tij  


**Opinion** **Ditës**  
Torturat makabre mbi trupin e 25-vjeçares Xhisiela Maloku nuk janë të rënda vetëm për përdhunimin sistematik, cigaret e fikura në kofshë, goditjet me qytën...  
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI  
Nënkomisari që na tregoi një përdhunim në grup



Fqinjët e 81-vjeçares: U tmerruam

## Vrau gjyshen, nipi: E godita në gjaknxehësi e sipër me thikë

Rrëfimi i 21-vjeçarit pas krimit: Pas vdekjes së babait, debatet ishin shtuar


Nga KLODIANA HAXHIAJ


**DURRËS** - Vrasja e 81-vjeçares Floresha Shkurti nga nipi 21-vjeçar ka shokuar jo vetëm familjarët dhe të afërmit, por edhe banorët e qytetit të Durrësit. "Jemi tronditur nga ajo që ndodhi. Të vrasësh nipi gjyshen që e ka rritur mes vuajtjesh të mëdha është...  
Në faqen 7

## VAJZA DENONCOI DHUNEN NGA DJALI I DEPUTETIT, ZBULOHEK DOKUMENTI

# EKSPERTIZA E MJEKUT: XHISIELA U RRAH DHE U DOGJ ME CIGARE

Policia e Shtetit: Ndalimi i Rexhep Rrajës nuk është kompetencë e jona. Flet psikologjia: Vajza më tha që është pënduar. Avokati: Pas kallëzimit, i thashë 'kujdes'

**Ekspertiza të përbashkura me sipër:**  
Në Durrësi, në shtetullën e djathtë dhe ekimozat e vërejtura në prapësi dhe këmbët e majtë, janë shikuar me një mbledhje. Në dy ditët e vërejtura në kofshën e djathtë janë shikuar nga veprimi i faktorit rritke siç mund të jetë edhe cigara.  
Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat në shtet për pasojë humbjen e aftësisë të përkohshme për punë në moshë 71 në 9 (nëntë) ditë.  
**EKSPERTI MJEKO-LIGJOR**  
Dr. Elton SERANI  




(Në foto) Faksimile e ekspertizës mjeko-ligjore. Rexhep Rraja



Në faqen 2-3

### "TE VENDOSUR DREJT BE"

**Meta në OKB: Shqipëria jep kontribut për paqen në botë**  
Në faqen 5

### INCIDENTI

**"Hajdut, kriminel", qëllohet me gurë makina e ish-ministrit Ilir Beqaj në Tiranë**  
Në faqen 4

### KOMISIONERI I BE

**Han nga Brukseli: Shqipëria në rrugë të mbarë, jam i kënaqur nga vetingu**  
Në faqen 4

### "BLEUTOOTH"

**Pritej dasma, por Stresi dhe Kejsi nuk janë bashkë, përfundon lidhja?**  
Suplement

### QARKU I LEZHES



**ALUIZNI: 600 personat që kanë gati lejet e legalizimit**  
Në faqen 8

Ceremonia/ Kryebashkiaku Erion Veliqaj: Falenderoj themeluesin dhe profesorët

## "Luarasi" diplomon brezin e 14 të studentëve

Rektori Et'hem Ruka: Universiteti ynë, ndër më të mirët në Shqipëri

Nga VOLTIZA DURO

**K**olegi Universitar "Luarasi" diplomoi brezin e 14-të të studentëve ditën e djeshme, çka përkonte edhe me datën e themelimit të tij, 15 vite më parë. Plot 200 juristë dhe ekonomistë të rinj të veshur me rrobën akademike



nuk mund t'i fshihnin emocionet. I krijuar në vitin 2003, "Luarasi" si institucion lider i dijes dëshmoi edhe njëherë se ka të gjithë potencialin për të përgatitur breza të denjë profesionalistësh, të cilët kanë në duar një dokument, i cili u jep siguri...  
Në faqen 11

# DOSJA "RRAJA" HETIMET

SHÇBA pas verifikimit: Deklaratat e oficerit Nuhu, të pabaza

## Policia e Shtetit: Vazhduam hetimin edhe pas tërheqjes së kallëzimit

"Oficeri Gentian Çitozi u pezullua pasi nuk mori denoncimin"

Policia e Shtetit doli në një deklaratë pas ditën e sotme në lidhje me rastin e Fushë Krujës, duke bërë të ditur se është pezulluar oficeri i policisë Gentian Çitozi, i cili nuk marrë denoncimin e vajzës në prani të Rexhep Rrajas. Në deklaratë drejtore dhe Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Aida Hajnaj tha se Policia ka vazhduar hetimet pavarësisht tërheqjes së kallëzimit nga ana e vajzës, madje është referuar edhe në prokurori si rast. "Oficeri i policisë Çitozi, nuk ka vepruar sipas ligjit, sepse ka qenë prezent edhe Rexhep Rraja dhe oficeri është pezulluar. Më pas është marrë kallëzimi i vajzës. Pavarësisht kërkesës së shtetasës që është tërhequr nga kallëzimi, policia ka vazhduar me çështjen. Çdo masë e ndalimit nuk është kompetencë e policisë. Policia nuk e ka ndaluar hetimin, por e ka referuar atë në prokurori", tha Policia e Shtetit. Nga ana tjetër, Drejtorja e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në policinë e shtetit, Anila Trimi, u shpreh se deklaratat e oficerit të policisë gjyqësore Emiliano Nuhu janë të pabaza. "SHÇBA ka filluar dhe është në vijim të një hetimi të thellë dhe të detajuar të të gjitha pretendimeve dhe deklaratave të bëra publike nga ish-punonjësi i Policisë së Shtetit Emiliano Nuhu, të bëra publike nëpërmjet një interviste të transmetuar në media", u shpreh ajo. Sipas SHÇBA nga hetimet e deritanishme është verifikuar se nga intervistat e drejtuesit dhe punonjësve të Policisë së Stacionit Fushë Krujë rezultojnë se më datë 21/07/2018, pra data e pretenduar, nga ish-punonjësi Nuhu nuk ka qenë fare prezent në ambientet e Stacionit të Policisë Fushë Krujë. "Nga Urdhri i Brendshëm për planëzimin e shërbimit, rezultojnë se, më datë 21/07/2018, Emiliano Nuhu nuk ka qenë OPGJ i gatshëm, por një tjetër punonjës i Policisë së Shtetit; Nga intervistat dhe dokumentet si dhe shqyrtimi i pamjeve filmike në dispozicion, nuk rezultojnë që personat e përmendur në intervistë, si kërcënues të tij, të kenë qenë prezent në ambientet e komisarariatit të Policisë së Shtetit në Fushë Krujë, as në këtë datë dhe as në ndonjë datë tjetër të mëvonshme", thuhet në reagimin e SHÇBA.

**DEKLARATA E POLICISË SË SHTETIT**

Jemi sot këtu për të informuar lidhur me veprimet e Policisë së Shtetit në trajtimin e çështjes që lidhet me shtetasen Xhisela Maloku. Drejtorja e Përgjithshme e



Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Aida Hajnaj, gjatë deklaratës për shtyp

**Grida Duma: Ngjarja, provë se kryeministri mbrosh kriminelët**

## Denoncimi: Polici i përjashtuar heton oficerin Emiliano Nuhu

**TIRANË** - Në një kohë kur ishte i pari që denoncoi rastin e oficerit Emiliano Nuhu, i cili pretendon se i kërcënua me jetë pasi hetoi djalin e deputetit të Krujës, Ramazan Rraja, për përdhunimin e një vajze, Berisha ka vijuar me të tjera akuzat. Përmasë një postimi në "Facebook" Berisha tregon se kush po heton çështjen e Nuhut. Duke iu referuar qytetarit dixhital, Berisha me ironi shkruan se krimi është meritë e lartësisim në poste për kryeministrin Edi Rama. Ndërkohë, qytetari dixhi-



tal thekson se hetimin e SHÇBA i është ngarkuar oficerit Fatos Hasani, që sipas tij është i korruptuar. Po ashtu qytetari shkruan se Hasani ka qenë i përjashtuar nga policia për "Shkelje të betim-

Policiës së shtetit, përmes Drejtorisë së Standardeve kreu një hetim administrativ të të gjithë veprimeve të kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit në trajtimin e kësaj çështje. Në përfundim të këtij procesi sgarojmë në mënyrë kronologjike se: Pasditën e datës 21 korrik 2018 rreth orës 17, pranë Komisarariatit Nr.3 në Tiranë është paraqitur shtetasja Xhisela Maloku, e cila ka deponuar kallëzim ndaj shtetasit Rexhep

Rraja për përdnjekje dhe kanosje me mesazhe telefonike. Për shkak të pengjesisë territoriale të vendbanimit kësaj shtetasjeje, në të njëjtën ditë në orën 21.40 pranë Stacionit të Policisë së Fushë-Krujës, shtetasja Xhisela Maloku është thirrur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Gentian Çitozi për të dhënë deklarinim e saj lidhur me ngjarjen. Kjo është bërë publike edhe nga komunikata ditore e Policisë së Shtetit e

it policor dhe abuzime të rënda me atributet e policisë". Ndërkohë nga selia blu, Grida Duma, theksoi se torturimi i vajzës nga Nikla është një provë se kryeministri Edi Rama mbrosh kriminelët. PD shton në reagimin e saj se djali i një deputeti që ka përdhunuar, rrahur dhe djegur me cigare në mish (sipas dëshmisë së vajzës) dhe që poston foto me armë dhe simbole me hashash, mbetet ende i lirë. Duma pohon se ky rast është vetëm maja e një ajsbergu që fshihet krime më të rënda të pazbuluara.

datës 22.07.2018 të cilën mund ta verifikoni në çdo moment duke vizituar faqen e internetit të Policisë së Shtetit. Oficeri i policisë Çitozi, nuk ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Penale për marrjen në pyetje të një shtetas, pasi prezent ka qenë edhe shtetas Rexhep Rraja, i cili është personi në hetim, me pretendimin se palët janë pajtuar midis tyre. Për këtë arsye oficeri Çitozi është pezulluar nga eprorët e tij, në

këtë rast nga Shefi i Komisarariatit

dhe është referuar në Prokurori nga SHÇBA. Ditën e hënë, më datë 23.07.2018, çështja e shtetasës Maloku është referuar në prokurori. Në këtë moment çështja kaloi nën kompetencë të prokurorisë dhe prokurorja duke e pasur tanimë çështjen nën kompetencën e saj, vendosi që këtë procedim t'ia kalojë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme oficerit të policisë Emiliano Nuhu, në datën 27.07.2018. Oficeri i Policisë Emiliano Nuhu, ka filluar të kryejë veprime me këtë çështje pas kësaj date. Në zbatim të urdhrin të delegimit nga Prokurorja nga 11 detyra ka zbatuar vetëm 4 prej tyre. Në asnjë prej këtyre detyrave të zbatuara, nuk është kryer marrja në pyetje e personit nën hetim Rexhep Rraja. Sgarojmë se marrja në pyetje e shtetasit Rexhep Rraja, marrja e tabulateve si dhe këqyrja e telefonit për këtë shtetas, ka qenë detyra e parë e deleguar nga prokurorja e çështjes, dhe që nuk janë zbatuar. Pavarësisht kërkesës për heqje dorë nga kallëzimi i vet shtetasës Maloku dhe kërkesës për ta tërhequr denoncimin, drejtuesi i Komisarariatit të Policisë Krujë, duke vlerësuar rëndësinë e këtij kallëzimi dhe duke vlerësuar faktet dhe rrethanat të lidhur me to, nuk ka lejuar ndërprerjen e hetimit. Pra, ndryshe nga sa paraqitet në media, shtetasja Maloku është tërhequr nga kallëzimi kurse policia nuk është tërhequr nga hetimi i çështjes. Madje brenda 24 orëve ka vazhduar procedurën me Prokurorin. Çdo masë sigurie, ndalimi ose arrestimi i tij, që pretendohet se mund të merrej ndaj shtetasit R.Raja nuk janë kompetencë e Policisë së Shtetit. Ligji jua njëjto të drejta vetëm Prokurorit dhe Gjykatës. Shtetasja Maloku është mirëpritur nga policia, Situatat e krijuara nga tërheqja e denoncimit të shtetasës, nuk i kanë dhënë policisë mundësi ligjore për të ofruar urdhrin e mbrojtjes.




**6 të arrestuarit e grupit "Bajri" kërkojnë lirinë**

**TIRANË** - Gjashtë nga nëntë personat e arrestuar si pjesë e grupit kriminal "Bajri" janë shprehur kundër masës së sigurisë, ndërsa kanë kërkuar lirinë. Ata kanë kërkuar një masë më të lehtë sigurie. Ankimet e Safet Bajrit, Ilir Rustemit, Emrah Plakut, Ismet Idrizit, Denis Brajovës si dhe Klaudio Hoxhallit u deponuan sot në gjykatë nga avokati Arbër Hoxha. Grupi i "Bajri" akuzohet për trafik ndërkombëtar droge, armëmbajtje pa leje, vrasje të mbetura në tentativë dhe shumë veprimtari të tjera të paligjshme. Pas caktimit të masës "arrest me burg", Arbër Hoxha, avokati i Safet Bajrit e ka cilësuar të paligjshëm vendimin e Krimeve të Rënda dhe tha se nga pala mbrojtëse u ofrua garancia pasurore, por kjo nuk u mor parasysh. Sipas tij, akuzat e vetme nga klientit të tij është jo për ndikim në gara sportive.



**A**vokati Elton Frangu, i cili ka qenë i pranishëm në komisariatit e policisë së Fushë Krujës, mbremjen kur Xhisela Maloku tërhoqi kallëzimin e bërë ndaj djalit të ish-deputetit të PS tregon se është thirrur nga oficeri i policisë, Gentian Çitozi. Frangu thekson se është thirrur pas orës 22:00 të mbrëmjes, ndërsa për datën thotë se nuk i kujtohet saktësisht, përveçse se ka qenë muaji korrik. Avokati shprehet se i është kërkuar të shkojë në komisariatit e policisë, Gentian Çitozi, pasi një vajzë kërkonte të tërhoqte një kallëzim penal të bërë mëngjesin po e asaj dite. Ai shton se në raste të tilla nuk është e nevojshme prania e avokatit, por ka vajtuar në komisariat për të mbrojtur interesat e vajzës. "I thashë të ketë kujdes, pasi ka bërë një kallëzim penal dhe mund të mbash përgjegjësi për dëshmi të rreme", është

**"Ishte vullneti i vajzës, s'kam pse ndikoj unë"**  
**Avokati: Pas tërheqjes së kallëzimit i thashë "kujdes, mos mbash përgjegjësi për dëshmi të rreme"**



**Avokati**  
 "I thashë të ketë kujdes, pasi ka bërë një kallëzim penal dhe mund të mbash përgjegjësi për dëshmi të rreme", është shprehur avokati. Ai sqaron se ka qëndruar vetëm për këtë moment në komisariat, dhe pasi e ka orientuar Xhiselën është larguar në mënyrë që të mos rëndohet pozitat e vajzës. ka parë persona të rrezikshëm jashtë komisariatit apo persona me armë, avokati thotë se ka qenë natë dhe nuk ka pasur shumë lëvizje. Në lidhje me gjendjen psikologjike të vajzës, Frangu thotë se më

mirë mund të shprehët psikologu që ka qenë, gjithashtu, i pranishëm në komisariat. Avokat Frangu thotë se nga momenti që është është larguar nga komisariatit nuk ka qenë më pjesë e kësaj çështjeje, por shpreh gatishmërinë e tij për t'u paraqitur në prokurori në rast se do të kërkohet nga organi i akuzës. Ndër të tjera ai tregon se tërheqja e kallëzimit është një shprehje e vullnetit personal, edhe pse në rastin në fjalë, avokati thotë se i është dukur e çuditshme pasi kallëzimi është kryer në mëngjes, po në mbrëmje është tërhequr. I pyetur nëse ka parë shenja dhune në trupin e vajzës, ai shprehet se nuk ka vënë re gjë.

Merret në pyetje motra dhe nëna e 25-vjeçares. Psikologja: Vajza më tha që ishte penduar

# Ekspertët mjeko-ligjorë: Xhisela Maloku u dhunua

*"Është goditur me mjete të forta dhe ka shenja të djegies me cigare"*

**X**hisela Maloku rezultoi në jetë dhunuar". Ky është përfundimi i ekspertizës mjeko-ligjore, i cili mbështet pretendimet e para të 25-vjeçares se ish-dashuri i saj Rexhep Rrajë, djali i deputetit të Partisë Socialiste Rrahman Rraja e ka dhunuar. Sipas ekspertizës, vajza kishte në kofshë shenja të djegies me cigare dhe në shpatull shenja plagësh të shaktuara me mjete të forta. Më 21 korrik të këtij viti e reja kallëzoi në polici Rexhep Rrajën, por e tërhoqi denoncimin dhe sipas ish-nënkomisarit Emiljano Nuho, e bëri për shkak të presioneve. Në ekspertizën mjeko-ligjore konfirmohet dhuna e ushtruar ndaj 25-vjeçares. "Dërrmishjtja në shpatullën e djathtë dhe ekimozat në pulpën dhe kërcirin e majtë, janë shkakuar nga veprimi i faktorëve termikë, siç mund të jetë edhe cigareja. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat në sjellë për pasojë humbjen e aftësisë të përkohshme për punë në masën 9 (nëntë) ditë.

Ekimozat në pulpën dhe kërcirin e këmbeve të majtë me lokalizim dhe karakteristika të përshkruara më sipër.

A)-Dërrmishjtja në shpatullën e djathtë dhe ekimozat e vërejtura në pulpën dhe kërcirin e majtë, janë shkakuar me mjet mbretës. B)-Dy dërrmishjtet e shprehura në kofshën e djathtë janë shkakuar nga veprimi i faktorëve termikë siç mund të jetë edhe cigareja.

Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat në sjellë për pasojë humbjen e aftësisë të përkohshme për punë në masën 9 (nëntë) ditë.

**EKSPERTI MJEKO-LIGJOR**  
**Dr. Elton Serani**

*Dr. Elton SERANI*  
**Ekspert Mjeko-Ligjor**

Faksimile e ekspertizës mjeko-ligjore

gorinë e atyre dëmtimeve, të cilat sjellin si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën prej 9 ditësh", thuhet në raportin e mjekëve ligjorë. Ekspertiza mjeko-ligjore i është vënë në dispozicion prokurorisë së Krujës, pasditen e 27 shtatorit 2018 dhe është administruar në dosjen hetimore

të Rexhep Rrajës, i cili ishte nën hetim për përndjekje, ndonëse kallëzuesja, ishte tërhoqur nga denoncimi. Pas njohjes me aktin, prokuroria ka ftuar në pyetje nënën dhe motrën e 25-vjeçares si dhe një mikeshë të Xhisela Malokut. Burime të besuara pohojnë se nëna e Xhiselës mohon të ketë pasur dijeni për problemet e të

bijës, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe shoqja e saj. Ndërsa e motra, ka pohuar për oficerët e policisë gjyqësore, se ishte në dijeni që Xhisela kishte debate me të dashurin e saj, por vetëm në një rast ka pasur zënkë mes tyre. Vajza e dhunuar deklaronte në kallëzimin e saj se ishte torturuar nga djali i deputetit Rexhep Rraja.

**EKSPERTIZA**  
 "Dërrmishjtja në shpatullën e djathtë dhe ekimozat në pulpën dhe kërcirin e majtë, janë shkakuar me mjet mbretës. Dërrmishjtet e vërejtura në kofshën e djathtë, janë shkakuar nga veprimi i faktorëve termikë, siç mund të jetë edhe cigareja. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve, të cilat sjellin si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën prej 9 ditësh", - thuhet në raportin e mjekëve ligjorë.

**PSIKOLOGJA**  
 Në një lidhje telefonike për Top Channel, psikologja, Anjeza Kallaku ka treguar se e ka telefonuar në orën 10 të natës oficeri policisë së Fushë-Krujës, që ajo të asistonte në tërheqjen e një padie dhune nga 25-vjeçarja me inicialet Xh.M. "Gentian Çitozi më ka marrë në orën dhjetë e çerek të

natës. Më tha që kishte një rast dhune dhe më pyeti a mund të vijja për një shtetase. I thashë që isha me pushime verore, por m'u lut që të vijja, sepse nuk kishin mundësi që të gjenin një psikologje tjetër. Jam shoqëruar në rajon me babain tim. Në komisariatit ishte Gentian Çitozi dhe një zotëri që po përfundonte dëshminë e tij. Nuk e njihja se kush ishte, më pas mora vesh që ishte ish-i dashuri i vajzës. Vajza erdhi më pas", tregon psikologja. Psikologja thotë se nuk ka informacion se përse vajza u tërhoq nga denoncimi, të cilin e kishte dorëzuar në të njëjtën ditë, por paradite. Vajza kishte deklaruar se ishte pajtuar. "Mua m'u bë prezent si çështje kalmtare. Thjesht që vajza ka kalluar dhe tani po e tërhoq padinë. Vajza më tha që ishte penduar. Nuk konstatova shenja frike, madje më duket në kushte normale. E këshillova që të kishte kujdes. Nuk kishte shenja dhune, por nuk mund të them më shumë", -thekson psikologja.

**EP** Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit material kombëtar për venienë në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhoma Kombëtare e Noterisë (Dh.K.N.) Ifton Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Dokumentat e projektit mund të terhiqen përkundrejt pageses prej **10.000 leke**, pranë Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tirane, Shqipëri.

Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

**EP** SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NUJFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

1- "Pyl" + Kullorë me sip. 280.000 m<sup>2</sup>. Nr. hipotekor 168 datë 29.05.2012. ZK 3028. e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raifaision sh.a. Cëmi me të cilin filon ankandi është 3.024.202 Euro. Ankandi zhvillohet datë 22.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Çetani", Pall. "Fratar", K.6.Tirane.

2- "Pyl" + Kullorë me sip. 45.000 m<sup>2</sup>. Nr. hipotekor 66 datë 25.03.2009. ZK 3028. e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raifaision sh.a. Cëmi me të cilin filon ankandi është 1.026.060 Euro. Ankandi zhvillohet datë 22.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Çetani", Pall. "Fratar", K.6.Tirane.

3- "Fisat" + Kullorë me sip.3.250 m<sup>2</sup> nga Kjo 14155 m<sup>2</sup> ndodhet me adresë: Kullorë, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raifaision sh.a. Cëmi me të cilin filon ankandi është 490.899 Euro. Ankandi zhvillohet datë 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Çetani", Pall. "Fratar", K.6.Tirane.

4-Për pasuritë me Nr.10071-1, vol.41, ta.9, ZK 8513, me sip.1192 m<sup>2</sup> me adresë Rr. "Mucot"15, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raifaision sh.a. Cëmi me të cilin filon ankandi është 36.036 Euro. Ankandi zhvillohet datë 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Çetani", Pall. "Fratar", K.6.Tirane

Për çdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në [www.epsh.al](http://www.epsh.al)

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYEQSORE "3H" Sh.p.k**  
 Rr. "Triën Daria", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tirane  
 Web: [www.3h.al](http://www.3h.al), Email: [shqji.3h@shq.com](mailto:shqji.3h@shq.com) call:0692099711

Njufton shpalljen e ankandit nga **dt.25.09.2018 deri në dt. 05.10.2018** për: sendin e luajtshëm njetit me targë AA 089 OB në pronësi të Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M  
 Cëmi fillestar është **1419 EURO**

Ankandi zhvillohet në zyren përmbaremore në datën **05.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**

## NEGOCIATAT PROCESI "SCREENING"

Komisioneri për Zgjerimin: I kënaqur nga vetingu, por s'kam datë fikse

# Procesi "screening" në Bruksel, Hahn: Shqipëria, në rrugë të mbarë Duhet rishikuar 160 mijë faqe legjislacion

Procesi screening që sapo ka nisur në Bruksel, përfaqëson hapin e parë drejt përgatitjes për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Komisioneri për Zgjerim në BE, Johannes Hahn përshëndeti nisjen e procesit në një konferencë të përbashkët për shtyp me ministrin e Drejtësisë, Etilda Gjonaj dhe zv/kryeministrin dhe ministrin për Punë të Jashtme të Maqedonisë, Bujar Osmani duke theksuar se kjo javë shënoi "takimin e parë në kuadrin e një sërë takimesh që kanë për qëllim transpozimin e legjislacionit të BE-së në legjislacionet e vendeve respektive". "Mesazhi im për delegacionet sot dhe qytetarët e vendeve tuaja është se puna tashmë ka filluar. Perspektiva e anëtarësimit në BE do të bëhet realitet që do të thotë se është bërë shumë punë dhe ka ende shumë punë për të bërë. Thëksin vazhdojmë ta vëmë tek shteti i së drejtës, i cili është veçanërisht shumë i rëndësishëm", tha Hahn. Para së gjithash, theksoi Hahn, "kemi hartuar një udhërrëfyes tejte ambicioz, i cili përgatit terrenin për punën që pritet të bëhet nga sot deri në shtatorin e ardhshëm. Kjo do të thotë se duhet të rishikojmë 160 000 faqe të legjislacionit. Ky screening shpjegues ashtu siç e quani ju, përfaqëson hapin e parë drejt përgatitjes për hapjen e negociatave të anëtarësimit". "Strategjia e Ballkanit Perëndimor, samiti i Sofjes dhe konkluzionet e këshillit në qershor tregojnë se kemi hyrë në një fazë tepër përcaktuese që do t'ju fuqizojë në zbatimin e reformave të nevojshme për anëtarësimin në familjen europiane", u shpreh Hahn. Ky, theksoi Hahn, "është një proces shqëror që do të sjellë një ndryshim në interesin më të mirë të vendeve tuaja dhe do të sigurojnë të mira konkrete për qytetarët tuaj duke ofruar mundësi të reja punësimi, duke garantuar shtetin e së drejtës dhe drejtësi për çdo qytetar. Është një investim për të ardhmen tuaj të përbashkët". Sigurisht, shtoi Hahn, "ky është vetëm fillimi dhe kemi shumë punë për të bërë, por unë kam besim se do e përmbushim këtë objektivi së bashku. Të dyja vendet janë në rrugë të mbarë, siç është konfirmuar nga Këshilli që miratoi rekomandimin e Komisionit, i cili parashtrroi rrugën e anëtarësimit për të dyja vendet". "Fakti që nuk kemi kohë për të humbur dhe duhet ta nisim procesin menjëherë tregon angazhimin e



Komisioneri për Zgjerim në BE, Johannes Hahn

**HAHN**  
"Strategjia e Ballkanit Perëndimor, samiti i Sofjes dhe konkluzionet e këshillit në qershor tregojnë se kemi hyrë në një fazë tepër përcaktuese që do t'ju fuqizojë në zbatimin e reformave të nevojshme për anëtarësimin në familjen europiane", - tha Hahn.



Gjatë një seance parlamentare

### Incidenti, përfshihet edhe një makinë me targa CD

## "Hajdut, kriminel", fyhet Ilir Beqaj. Qëllohet me gurë makina e ish-ministrit

Një mesoburrë rreth të dyzetave ka alarmuar dje ish-ministrin e Shëndetësisë, Ilir Beqaj dhe policinë e Shtetit pasi në mënyrë të papritur ka nisur të fyejë ish-ministrin dhe të qëllojë automjetin e tij. Gazetarët e "Gazetës Shqiptare" kanë rastisur në vendngjarje dhe e raportuan menjëherë incidentin që ka ndodhur rreth orës 17:00 të pasdites.

Ilir Beqaj shoqërohej nga persona të tjerë, të cilët ishin pranë dy makinave të tyre, një Volkswagen Touareg dhe një Mercedes me targa diplomatike, kur një i panjohur ka nisur të bërtasë "kriminel, hajdut" dhe fjalë të tjera fyese.

Ky person ka rrëmbyer një vazo ndanë rrugës dhe



ka qëlluar në fillim "Mercedesin" me targa diplomatike, ka vazhduar ta godasë makinën me shkelma dhe më pas ka rrëmbyer një copë të madhe betoni dhe e ka plasur në xhamin e përparmë të makinës së Ilir Beqajit.

Ish-ministri dhe personat që e shoqëronin kanë ruajtur gjakftohësinë, kanë

nxituar të hipin në makinë dhe kanë lëvizur 50 metra më tej. Autori i incidentit u largua me qetësi. 10 minuta më pas në vendngjarje ka ardhur policia e Shtetit. Touaregu me ngjyrë gri është i njëjti që është qëlluar me vezë nga aktivistët e "Aleancës Kuqezi" në vitin 2016.

fortë të Komisionit për të shoqëruar të dyja vendet në rrugën e reformave dhe për ta bërë realitet perspektivën e integritimit në BE. Ky është një sinjal i angazhimit të BE-së dhe besueshmërisë së procesit të zgjerimit në të gjithë rajonin", tha Hahn. "Kur vendet shënojnë progres në zbatimin e reformave, si Shqipëria ashtu si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,

atëherë BE e mban fjalën e dhënë. Ne po e mbajmë fjalën, sepse po ecim përpara në këtë proces të anëtarësimit. E vlerësojmë shumë faktin që përfaqësuesit politikë në nivele drejtuese po u bashkohen ekspertëve në këtë takim të parë në mënyrë që të japin instruksionet dhe orientimet politike, por edhe të shprehin vendosmërinë në nivel politik për të ecur përpara,

sepse, siç e thashë, kemi një kalendar ambicioz, por do donim të përmbushim objektivat tanë, që do të thotë ta mbyllim punën përgatitore në verën e vitit të ardhshëm në mënyrë që të vijojmë me hapat e tjerë të rëndësishëm", theksoi Hahn. "Shqipëria ka bërë progres sa i takon reformës në drejtësi dhe është në rrugën e duhur drejt BE", - u shpreh Hahn.

### Siguria në rajon, Bushati me Mitchell: SHBA vlerëson rolin e Shqipërisë

Në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati zhvilloi një takim me Asistent Sekretarin Amerikan të shtetit Wess Mitchell. Gjatë këtij takimi biseda u përqendrua tek niveli i shkëlqyer i marrëdhënieve mes dy vendeve tona dhe rolin kyç të Shqipërisë si faktor paqje dhe stabiliteti në rajon. Zyratë diskutuan mbi perspektivën e integritimit evropian dhe reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës. Asistent Sekretari i Shtetit Mitchell shprehu mbështetjen e pakursyer të SHBA-ve për perspektivën e integritimit evropian si dhe shprehu vlerësimin për pozicionin dhe kontributin e Shqipërisë në lidhje me sfidat më të mprehta të sigurisë në rajon e më gjerë. Ministri Bushati është takuar edhe me homologun gjerman. Në një postim të tij në Instagram, vetë ministri i Jashtëm i Gjermanisë Hieko Maas shkroi për takimin me Bushatin: "Në çdo cep të njohur të vjetër".

### Ish-deputeti i PD-së, Patozi: Shqipëria në batak, ka nevojë për një lëvizje

Shqipëria sot është në një batak, e cila mund të shpëtojë nga një lëvizje". Kështu është shprehur në studion e "Provokacija" ish-kreu i grupit parlamentar Astrit Patozi. Sipas tij Shqipëria e ka të domosdoshme këtë lëvizje, ndërsa pret që t'i bashkohen shumë njerëz. "Unë mendoj që Shqipëria ka nevojë për këtë lëvizje, unë nuk jam as delirant, as mitoman. Nuk mendoj që jam Mesia që duhet të shpëtojë PD-në, apo Shqipërinë nga zgjedhja, por do pres që kësaj zgjedhjeje t'i bashkohen shumë njerëz dhe do isha i motivuar që të jepja kontributin tim për këtë lëvizje", - deklaroi Patozi. Ai shtoi se kjo lëvizje duhet të lindë nga opozita. "Jo domosdoshmërisht duhet të lindë nga PD, unë dua të lindë nga PD se ajo sot është në opozitë. Në rast se ruajmë sistemin kështu siç është në jemi në vend numëro për të mos thënë hapa mbrapa", - tha Patozi.



Presidenti, thirrje vendeve anëtare të OKB: Vazhdoni me njohjen e Kosovës

# Meta në OKB: Shqipëria kontribut për paqen, të vendosur drejt BE

*"Krah jush për të kapërcyer sfidat e përbashkëta"*

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ndodhet në SHBA, ku po merr pjesë në Sesionin e 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Gjatë fjalës së tij, z.Meta vuri në dukje se Shqipëria ka kontribut në forcimin e paqes e sigurisë në botë dhe se është e angazhuar për stabilitetin dhe integritetin e gjithë Ballkanit në strukturat euro-atlantike. "Shqipëria, si vend me kontribute të vlefshme në vendosjen dhe ruajtjen e paqes, qëndrueshmërisë, përparimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave universale të njeriut dhe duke besuar fort në multilateralizmin, synon të zgjidhet e të jetë një anëtare jo e përhershme i Këshillit të Sigurimit për mandatin gjatë viteve 2022-2023. Për të arritur këtë qëllim, ne jemi të gatshëm të angazhohemi në mënyrë konstruktive në parandalimin e konflikteve dhe në operacione të ndryshme paqësore, si në kuadër të OKB-së, ashtu dhe në organizata të tjera të sigurisë rajonale, në zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të kontribujmë në respektimin universal të të drejtave të njeriut. Shqipëria është e angazhuar për të mbrojtur dhe promovuar të gjitha të drejtat e njeriut si dhe mbështet integritimin e dimensionit të të drejtave të njeriut në axhendën e Kombeve të Bashkuara", theksoi z. Ilir Meta. Në fjalimin e mbajtur në Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Presidenti Ilir Meta mbështeti parimet dhe principet e kësaj organizate, ndërsa u shpreh se Shqipëria është e vendosur të vazhdojë rrugëtimin integruar në BE, duke përparuar me reformat. "Ndërsa presim një vendim pozitiv në të ardhmen për të hapur negociatat e pranimit me Bashkimin Europian, ne mbetemi të përkushtuar për të ecur përpara dhe pa vonesë me reformat e brendshme në fusha kyçe. Ne, gjithashtu, e konsiderojmë përparësinë e BE për bashkëpunim të hapur rajonal si një politikë të domosdoshme", theksoi z.Meta.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dje në SHBA

**DEKLARATA**

"Ndërsa presim një vendim pozitiv në të ardhmen për të hapur negociatat e pranimit me BE, ne mbetemi të përkushtuar për të ecur përpara dhe pa vonesë me reformat e brendshme në fusha kyçe. Ne, gjithashtu, e konsiderojmë përparësinë e BE për bashkëpunim të hapur rajonal si një politikë të domosdoshme", theksoi z.Meta.

**DENONCIMI**

Këshilltari ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi zbardhi dje një sërë pasurish të paluajtshme që sipas tij Ervin Bushati nuk i ka deklaruar. Sipas tij, Ervin Bushati u bë deputet vetëm se i falli për 1 euro gruas së Edi Ramës tokën në Surrël dhe se ka fshehur 7 pasuri mes të cilave 3600 m<sup>2</sup> tokë truall.



## Nishani: Me krimin të përballlemi ashpër!

Përballje më të ashpër dhe të përshkallëzuar ndaj krimin të veshur me pushtet. Këtë kërkon ish-Presidentit Bujar Nishani nga studio e emisionit "Politika online" të gazetarit Harbi Aliaj. "Sot situata kur unë them që kupa është derdhur, të jesh civil dhe të jesh europian nuk përjashtohet të jesh i vendosur në përballjen me krimin. Krimi nuk ka dinjitet, krimi nuk ka kufij, krimi nuk ka kode dhe për me tepër kur krimi është i veshur me uniformat e pushtetit atëherë padyshim që këmbëngulja, dinamika, nervi duhet të jetë edhe më i madh çdo ditë e më shumë", tha z.Nishani. Teksa e konsideron të paralizuar organin e prokurorisë dhe të dështuar punën e Arta Markut përmend këto arsye: "Procesi i zgjedhjes së kryeprokurores ishte një proces anti-kushtetues. I denoncuar, zhgënjyes dhe i pabesueshëm në pjesën më të madhe të opinionit publik. Në këtë rezultat do të jetë një paralizë institucionale nga ana e institucionit të prokurorisë së shtetit shqiptar, për fatin e keq".

## Zgjedhje pa Ramën? Aleatët e PD kundër bojkotit

### Paralajmërimi i Palokës: S'kthehemi në Kuvend pa vetingun e politikës

Opozita nuk do të jetë në parlament pa u miratuar propozimi për veting të politikës. "Do të reagojmë në formë tjetër. Absolutisht jashtë parlamentit. Në cilin parlament të shkojmë ne? Në atë parlament ku janë përdhunuesit, ata që mbrojnë përdhunuesit, përfaqësuesit e krimin, aty të shkojmë dhe ne, të bëhemi fasadë që Rama të bëjë ato batutat e tij bajate që i janë shpifur dhe neveritur kujtdo. Për këtë duhet të shkojmë në parlament", tha z.Paloka. Bojkoti i Kuvendit është vetëm njëra anë e bojkotit të opozitës. Përtej bojkotit dhe denoncimit të aferave të qeverisë, duket se PD po përparimet për protesta. "Ajo që duhet të bëjë opozita është që përveç pjesës që i takon dhe e bën çdo ditë, denoncimin e skandaleve të kësaj qeverie, është që duhet të bëjë thirrje popullit të dalë në rrugë dhe të rrezojë këtë



qeveri. Populli e rrezojnë. Në shumë aludime, ç'a bën opozita, ku është opozita, pse nuk diskutohet. Pushteti në Shqipëri edhe kur shkëmbehet do shkëmbehet nëpërmjet votës. Kush shtyn me idenë që këtu të nxisim rrëmujë, protesta me armë e këshu shprehish, këto janë të gjitha debate të kota, të panevojshme që e demtojnë opozitën", deklaroi z.Shehi. Mbi nevojën e procesit zgjedhor shprehet edhe kreu i republikanëve. "Nuk ka rrugë tjetër për të ndryshuar realitetin përveç se përmes procesit zgjedhor. Çështja është që shqiptarët kanë nevojë të kenë zgjedhje të lira, të drejta dhe të ndershme ku qytetarët vendosin kush drejton nivelin lokal apo nivelin qendror. Rama ka qenë manipulator me zgjedhjet. Sa kohë do të jetë Rama në pushtet nuk mund ta kemi këtë klimë për zgjedhje të lira dhe të ndershme", deklaroi z.Mediu.

fundit, dhe pritet që të përfundojë me një marrëveshje të detyrueshme ligjore mbi normalizimin të rësor të marrëdhënieve midis dy shteteve. Është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe që kjo marrëveshje e pritshme të mishërojë energji pozitive, duke nxitur e ushqyer vlerat europiane të bashkëjetesës dhe harmonisë ndëretnike", theksoi z.Meta. Presidenti u bëri thirrje sh-

teteve anëtare të OKB-së që të vazhdojnë me njohjen e shtetit të Kosovës. "Ne u bëjmë thirrje dhe mirëpresim opozitës që të shteteve anëtare të OKB-së për vazhdimin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës si dhe mbështetjen e mëtejshme të anëtarësimit të saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Bazuar në stabilitetin dhe zhvillimet pozitive në Kosovë, Shqipëria mbës-

het reduktimin e seancat që mbahen në Këshillin e Sigurimit të OKB-së mbi raportet e UNMIK-ut", theksoi z.Meta. Kreu i Shtetit shprehu, gjithashtu, mbështetjen për ratifikimin përfundimtar të marrëveshjes së Prespës të arritur mes Shkupit dhe Athinës për çështjen e emrit, ndërsa inkurajoi dhe faktorin politik shqiptar që të luajë rolin e tij në këtë drejtim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Zyra përbarimorë "Best 2018"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 19 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e l-rë, për shtjjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq 39, ZK.8350, sip. 103.90 m2 me çmim fillestar 81.600 lek/m2.

Apartamenti ndodhet në Tiranë (prapa Prokurorisë Rrethit Tiranë).

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Deputeti i Partisë Socialiste, Ervin Bushati akuzoi dje kreun e PD, Lulzim Basha, se e ka vendosur partinë në shërbim të interesave të familjes. Përgjigja nga kreu demokrat erdhi nga Gazmend Bardhi, këshilltari ligjor i PD-së, i cili tha se e gjithë vëmendja e Ramës është për klientët e oborrit. "Lulzim Basha po përpigjet të heqë vëmendjen nga skema e tij e gjobëvënies, duke sulmuar përditë çdo deputet të Partisë Socialiste, që publikon prova kundër kumatit të tij. Përse një parti që ka heshitur kur humbi zgjedhjet dhe për shumë çështje të tjera me interes publik, është kaq e ndjeshme kur përmendet kuletat e kumatit. Kjo pro-

**Përplasje mes PD e PS për pasuritë**


**Bushati: Kompanitë e listës së zezë të Bashës. PD: Fshehu pasuritë e paluajtshme**

**GJOBVENIET**

"Lulzim Basha po përpigjet të heqë vëmendjen nga skema e tij e gjobëvënies, duke sulmuar përditë çdo deputet të Partisë Socialiste, që publikon prova kundër kumatit të tij. Përse një parti që ka heshitur kur humbi zgjedhjet dhe për shumë çështje të tjera me interes publik, është kaq e ndjeshme kur përmendet kuletat e kumatit".

von atë që ka kohë që flitet brenda Partisë Demokratike: Luli ka vendosur të gjithë partinë në shërbim të interesave të ngushta të familjes së tij! Ditë pas dite ju kemi treguar se si brenda një viti, kumati përfitoi 220 milionë lekë nga kompania 'Gener 2' dhe mbi 100 milionë lekë prej

grupit 'Kastrati'. Të dy këta biznesmenë kanë rënduar në 'listën e zezë', të atyre që Basha i anatemon si kriminelë dhe oligarkë. Sot ju sjellim një tjetër rast! 'Intersig' dhe 'Noa', dy kompani në pronësi të Gentian Sulës, kanë rerdhur në llogari të kumatit me dhjetëra milionë lekë brenda një viti të vetëm. Edhe ky biznesmen figuron në listën e Lulit', tha Bushati. Ndërsa PD, përmes Gazmend Bardhit u shpreh



se, "Ervin Bushati, i cili u bë deputet vetëm se i fali për 1 euro gruas së Edi Ramës, tokën ku Rama ka ngritur vilën miliona euroshe, doli prapë sot për të shpifur kundër opozitës. Ervin Bushati që, me kompaninë 'Bus-

hathi shpk.' ka marrë miliona nga tendera shtetërorë dhe miliona të tjera nga oligarkët e Ramës, shpif për opozitën për të mbrojtur paratë e tij, të padronit të tij dhe të klientëve të Edi Ramës", tha Bardhi.


**Qeveria "zbarkon" në Korçë. Kryeministri, thirrje emigrantëve: Financoni në agroturizëm**

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje nga Korça se fokusin e plotë qeveria e ka te njerëzit dhe jo te debatet me kundërshtarët politikë. Gjatë aktivitetit për ndarjen e kartave të reja të anëtarësisë, Rama tha se Korça është kthyer në një qendër të vërtetë ekonomike, edhe pse mbetet akoma shumë punë për të bërë. "Fokusin tonë e kemi te njerëzit dhe shumë më pak te kundërshtarët. E gjithë vëmendja për ju do të thotë të jemi të fokusuar plotësisht tek ekonomia, punësimi, shëndetësia, arsimi, tek të gjitha këto që janë pjesë e punës sonë jashtë ekraneve, por të kthehen në qendrën e komunikimit dhe debatit. Ajo që flitet e gjykohe shumë, s'ka lidhje fare me ato që janë problemet tuaja nga mëngjesi deri në darkë. Sfida është të krijojmë gjithnjë më shumë mundësi të reja. Se flitet për rroga e pensione, por në fund harrohet që edhe shtëpia e përbashkët e shtetit, është si shtëpia e secilit. Nuk ka prind që nuk do që t'i japë më shumë lekë fëmijës, por pse nuk e bën, se aq janë mundësitë. E njëjta gjë është ajo që bëjmë", u shpreh Rama. Sipas tij, "punësimi në Shqipëri po rritet, edhe pse s'po rritet aq sa donim. 20 mijë njerëz janë futur në punë nga janari, rritja e punësimit në Shqipëri është më i larti në të gjithë rajonin. Ne kemi nxjerrë dhjetëra mijëra njerëz në të zezë, që kompania t'i paguajë të gjitha". Kreu i qeverisë u përgjigj edhe zërave kritikë për bonusin e bebeve. "Ka

**Rama: Kemi fokusin te njerëzit, jo te kundërshtarët, punësimi u rrit**

*Bonusi i bebes, ka vende në BE që e japim vetëm për të varfrit*



vende në Bashkimin Europian që bonusin për të porsalindurit nuk e japin për të gjithë fëmijët, por vetëm për shtresat në nevojë, ndërkohë që në Shqipëri do të aplikohet për të gjithë fëmijët", tha ai. "Duke bërë reformat - tha Rama - u krijuan këto mundësi". Kryeministri kujtoi se qeveria realizoi një reformë për energjinë që ishte shumë e dhimbshme, por falë faktit që kemi më pak borx-

he, tani kemi më shumë mundësi. "Thoshte dikush: po pse s'e bën 18 vjet si në Gjermani? Se Gjermania, për çdo fëmijë të porsalindur nuk paguan vetëm vitin e parë. Ne do paguajmë vetëm vitin e parë. Pagan shumë më tepër. Po, sepse nuk jemi Gjermania, është shumë e thjeshtë. Prandaj nuk e bëjmë si Gjermania, sepse nuk jemi Gjermania. Ka vende në BE që nuk e japin

**MBLEDHJA E QEVERISË**  
Këtë muaj, qeveria do të mbledhet në Korçë. Sot, në ditën e dytë është parashikuar një vizitë e kryeministrit Rama në fshatin Sovjan, në një shtëpi të një familjeje të varfër, që do të rindërtohet. Rreth orës 12:30 minuta kryeministri do të mbledhë ministrat e deputetët të shtëpia e Flamurit, e cila do të pasohet me një deklaratë për shtyp, ku do të njoftohen edhe vendimet e reja të qeverisë.

për të gjithë fëmijët, por vetëm për ata të shresave në nevojë, ne do ta japim për të gjithë fëmijët. Kaq është mundësia e re që është krijuar sot", sqaroi kryeministri. "Unë jam i bindur që pas disa vitesh do hapet debati ta shtrimë në më shumë vite. Pra, një fëmijë që lind sot, të marrë shpërblimin për këtë vit, edhe për vitin tjetër, edhe për tjetrin. Por, që të arrijmë aty duhet të krijojmë mundë-

**Ambasada e SHBA: Prokurorët e ndershëm të aplikojnë në KLP**

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare të saj theksoi se Shqipëria është shumë afër krijimit të një sistemi drejtësie në shërbim të qytetarëve. "Shqipëria është në prag të krijimit të një sistemi drejtësie, që vërtet u shërben interesave të qytetarëve të saj. U bëjmë thirrje prokurorëve të ndershëm, patriotë dhe me integritet që të bëjnë përpara dhe t'i shërbejnë vendit të tyre në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Bëhuni pjesë e së ardhmes së Shqipërisë", shkruhet në reagimin e Ambasadës së SHBA në Tiranë.

si të reja. Dhe si i krijojmë mundësitë e reja? Mundësitë e reja i krijojmë duke bërë reformat, duke shkuar më tutje", vijoi kreu i qeverisë. Projekti Më herët kryeministri Edi Rama ishte në takimin e organizuar në Pustec, në kuadër të programit "100 fshatrat". Ai u sqaroi fermerëve se qeveria financon agroturizimin, ndaj i nixti që të ndërmarrin nisim të tilla. "Kjo është një iniciativë që nga natyra e vet dhe nga natyra e migracionit në të gjitha zonat, të cilat prek programi i 100 fshatrave është si e krijuar me dorë për emigrantët, që kurimet e tyre t'i investojnë në shtëpitë që kanë lënë, ku kanë prindërit, të afërmit, apo ku nuk kanë asnjëri. Të investojnë në tokat që kanë lënë, për të ndërtuar një agroturizëm, duke filluar nga një bujtinë e vogël tek një agroturizëm më i madh dhe për t'i kthyer kursimet në një investim, që do të sjellë për ta shumë më tepër të ardhura sesa sjell puna e përditshme dhe e vështirë që shumëkush bën sot në Greqi, apo në Itali, apo në një vend tjetër në emigracion", tha Rama.

**Shoqëria përbarimore JUSTITIA**  
shpall ankandin, faza DYTE, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Trulli - Ndërtues me sip, totale prej 250 m<sup>2</sup>, nga ku trulli 250 m<sup>2</sup>, dhe ndërtues 101 m<sup>2</sup>, nr. pasurie 9/33. Vol. 16/ fq. 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. 'Sheq i Madh' Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.640.000 (tre milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë.  
Ankand zhvillohet në datën 25.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

**Shoqëria përbarimore JUSTITIA**  
shpall ankandin, faza e parë për shitjen e pasurisë së paluajtshme sipas Çertifikatës provizore për regjistrimin karabina: Pasuri e paluajtshme, Apartament me sipërfaqe 70m<sup>2</sup>, e regjistruar në regjistrin hipotekor me Nr.117, datë 28.04.2009, me Nr. Pasurie 62-1-1, në Zonën Kadastrale 3126, me Adresë: Shëngjin, Lezhë, regjistruar në emër të Shaban Elezi dhe Taze Smalaj, hipotekuar në favor të BKT BANK. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 2.400.000 (dy milion e katërqind mijë) lekë.  
Ankand zhvillohet në datën 16.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi 'Bajram Curri', Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890/0693177499

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**  
**ZYRA PËRBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**  
PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT 'ARË', VOLUMI 1, FAQEJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPËRFAQJE 4.453 m<sup>2</sup>, NË ADRESËN: XHAFZOTAJ, DURRËS, NË PRONËSI TË Z. NEXHMI VORA,  
ÇMIMI 17.812.000 LEKË.  
Data e zhvillimit të ankandit do të jetë 08.10.2018.  
CEL. 0684026666 ; 0693262866

Fqinjët e viktimës: Jemi të shokuar nga ngjarja, kjo është dita e qametit

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Vrasja e 81-vjeçares Floresha Shkurti nga nipi 21-vjeçar ka shokuar jo vetëm familjarët dhe të afërmit, por edhe banorët e qytetit të Durrësit. "Jemi tronditur nga ajo që ndodhi. Të vrasë nipi gjyshen që e ka rritur mes vuarjesh të mëdha është e tmerrshme. Ka ardhur dita e qametit. Ky është qameti i madh", tha një grua e moshuar. Pas ngjarjes së rëndë janë hapur dyert e mortit në apartamentin e familjes Shkurti, në katin e tretë të një pallati në lagjen nr.16 të këtij qyteti. Dy vajzat e viktimës kanë mbërritur me shpejtësi nga Italia ku jetojnë prej vitesh me familjet e tyre. Të shumtë janë të afërmit dhe komshinjtë që shkojnë për ngushëllim. Ata thonë se është e patolerueshme të ngrejë dorë nipi mbi gjyshen e të kryejë një krim të tillë. Ndërkohë, burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit bënë me dije se është dokumentuar që autori i krimit të rëndë është 21-vjeçari Redmond Gruda, i cili banonte me gjyshen e tij dhe që ishte i shkuar si përdorues i lëndëve narkotike. Mësohet se mesditën e së enjtes, i riu pas një konflikti me gjyshen e ka goditur atë disa herë me thikë në kokë duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme. Gjatë marrjes në pyetje, i riu fillimisht ka mohuar krimin, por pas disa orësh në komisarjat, ai ka pranuar autorësinë duke dhënë edhe dëshminë e tij.

#### DËSHMIA E VRASËSIT

"Në shtëpi jetonim me mamën dhe me gjyshen, por faktikisht ishim të ndarë dhe secili rrinte për hesapin e tij. Që prej vdekjes së babait, debatet me gjyshen ishin të vazhdueshme dhe shpeshishin. Sot (dje) debatova shumë me gjyshen dhe në gjaknxehtësi e sipër e godita me majën e thikës në kokë", ka thënë 21-vjeçari, Redmond Gruda, i cili akuzohet për vrasje me dashje. Mësohet se viktima jetonte me nusen e djalit dhe nipin e saj, pasi djali i saj kishte ndërruar jetë disa vite më parë nga një sëmundje e rëndë. Burime nga grupi hetimor pohuan se i riu ka tentuar të fshehtë provat e krimit dhe se ishte ekspertiza, që saktësoi se 81-vjeçarja Floresha Shkurti ishte vrasë me thikë pas koke dhe nuk kishte pësuar vdekje aksidentale, siç dyshohe fillimisht.

#### FQINJËT E VIKTIMËS

Krimi në familje ka tronditur Durrësin. Fqinjët të familjes Shkurti u shprehën se Floresha ishte një grua e mirë dhe se kishte bërë gjithçka për të rritur fëmijët e saj e më pas nipërit. "Gjy-

# Vrasja e 81-vjeçares, nipi: E godita me thikë në gjaknxehtësi e sipër

## "Pas vdekjes së babait, konfliktet me gjyshen ishin të vazhdueshme"



Viktima Floresha Shkurti



21-vjeçari i arrestuar, Redmond Gruda

shja i rriti të dy nipërit, pasi i ati i tyre u nda nga jeta në moshën 50-vjeçare nga një sëmundje e rëndë. Floresha ishte me orgjinë nga Pogradeci. Ajo kishte kaluar një jetë me shumë vështirësi. Ishte divorcuar shumë e re dhe kishte rritur të tre fëmijët e saj e i kishte martuar. Rriti edhe dy nipërit, Redmondin dhe të vëllain e tij, por fati i keq nuk iu nda as në fund të jetës", thanë fqinjët e viktimës. "E mirë ishte e shkreta me të gjithë. Ishte grua e qetë. Nuk kemi dëgjuar për ndonjë sherr. Pasi morëm vesh lajmin, jemi habitur. Ndihemi të frikësuar nga kjo që po ndodh në familjerë shqiptare. Të ngrejë dorë dhe të vrasë nipi gjyshen që të ka rritur, ushqyer dhe të ka dhënë dashuri gjatë gjithë jetës është e tmerrshme", pohoi një fqinje tjetër e 81-vjeçares Floresha Shkurti.

#### GJYSHET E VRARA NGA NIPËRIT PRECEDENTET

- Në prill të vitit 2017 në lagjen nr.10 të Durrësit, policia njoftoi se u gjetën pa shenja jete Ersid Curri 25 vjeç dhe gjysha e tij 80-vjeçare Hurme Curri. Nga hetimet rezultoi se i riu kishte vrarë me automatik gjyshen e moshuar dhe më pas nga tronditja i ka dhënë fund jetës. Në atë kohë, policia deklaroi se i riu vuante nga depresioni dhe krimi u krye në kushtet e gjendjes së rënduar psikologjike.
- Në maj të vitit 2015, 82-vjeçarja Angje Hila u mbyt me jastëk nga mbesa Xhoana Hila në Shkodër. E reja, bashkëpunoi në krim me të dashurin e saj, Erando Qatiri. 32-vjeçarja ka pranuar se kishte djepur krimin, por ajo ia adresoi autorësinë të dashurit të saj. Gjatë dëshmisë së saj, ku shfaq shenja pendese, vajza pohoi se "gjyshen e mbyti i dashuri me jastëk", ndërsa po tentionin ti vidhnin asaj florinjët.
- Kumbulla Papajani është një tjetër gjyshe, viktimë e konfliktit me nipin e saj, 77-vjeçarja u gjet e masakruar me thikë në korridorin e apartamentit ku banonte në rrugën "Muhabet Gjollës" në Tiranë. Ngjarja e rëndë tronditi opinionin publik, ndërsa për disa ditë u bë temë e ditës në medianë dhe shkruar dhe atë televizive. Pas komunikimit të arrestit në kushtet e flagrancës, me akuzën e vrasjes së gjyshes për motive të dobëta, Klajdi Papajani pranoi krimin dhe tha se kishte vrarë gjyshen e tij në gjaknxehtësi e sipër. Para grupit hetimor, Papajani, asokohe 17 vjeç, u shpreh se vazhdimisht grindej me gjyshen, ndërsa pohoi se, "gjyshja na e ka nixirë jetën. Nëna dhe babai kanë vuajtur për shkak të saj".
- Ngjarja më e fundit u shënuar dy ditë më parë, më 27 shtator 2018, kur 81-vjeçarja Floresha Shkurti u gjet e vdekur në banesë. Edhe në këtë rast hetimet konfirmuan se e moshuara ishte viktimë e nipit të saj, 21-vjeçarit Redmond Gruda, i cili jetonte bashkë me të në një shtëpi. I riu goditi me thikë në kokë gjyshen e tij, duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme.

**SHKODËR** - Gjykata e Shkodrës ka rivlerësuar dje masën e sigurisë duke lënë në burg ish-drejtorin e Hipotekës, Zamir Leka dhe "Arrest shtëpie" për juristen Frida Mirashi. Ndërkaq, shtetas Erjon Cubaj, i cili ka përfutur një dokument pronësie u la me masën lehtësuese "Detyrim paraqitje", ndërsa më parë ishte në "Arrest me burg". Gjatë seancës gjyqësore, ish-kreu i Hipotekës së Shkodrës, Zamir Leka, i cili dyshohet për korrupsion nga pro-



## Akuzohet se merrte 5 mijë euro ryshfet, lihet në burg ish-drejtori i Hipotekës, Zamir Leka

kuroria nuk pranoi asnjë prej akuzave të ngritura ndaj tij se merrte deri në 5 mijë euro për një praktikë. Leka mohoi se ka bërë korrupsion gjatë 8 muajve të ushtrimit të detyrës. Ai dhe avokati i tij kërkuan një masë lehtësuese duke pasur parasysh se nuk është një person me rrezikshmëri që mund të largohet,

përkundrazi ka shprehur gatishmërinë për t'i shkuar deri në fund këtij procesi hetimor ndaj tij, por duke qenë i lirë edhe si një person publik. Po ashtu, pala mbrojtëse dhe vetë drejtori Leka kanë kërkuar "Detyrim paraqitje" edhe për shkak të rrethanave familjare duke qenë se bashkëshortja e drejtorit aktual-

ishtë është shtatzënë dhe ka nevojë që bashkëshorti të jetë pranë saj. Drejtori Leka që u arrestua ka shprehur gatishmërinë për t'u liruar edhe përmes vendosjes së garancisë pasurore, por gjykata nuk ka marrë parasysh asnjë prej rrethanave dhe kërkesave të tij dhe palës mbrojtëse.

#### SHKURT

#### Arrestohet 46-vjeçari i dënuar për prostitucion në Itali

DURRËS - Policia e Durrësit ka arrestuar në port një 46-vjeçar të shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi rezultoi i dënuar me 10 vite burg e 11 muaj burg në Itali për disa vepra penale. Bëhet fjalë për shtetasin Ermal (Alberto) Daci, banues në Tiranë. Mësohet se Gjykata e Apelit në Napoli, Itali, e ka dënuar me 10 vite e 11 muaj burg për veprat penale "Shfrytëzim prostitucioni", "Rrëmbim personi" dhe "Marrëdhënie seksuale me dhunë" parashikuar. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme.

#### FNSH dhe policia vënë në pranga hajdutin e 400 mijë eurove në Greqi

SARANDE - Policia e Sarandës dhe e Delvinës të mbështetura nga FNSH kanë kryer kontrolle në lokale dhe akse rrugore për parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe kapjen e autorëve të ndryshëm të veprave penale. Si rezultat i kontrolleve dhe informacioneve të marra në rrugë operative u kap një shtetas i shpallur në kërkim ndërkombëtar për vjedhje në shuma të mëdha të parave kryer në Greqi, si dhe u arrestua një tjetër person për posedim të lëndëve të forta narkotike. Gjatë kontrolleve në lokale e natës u shoqëruan për verifikim 9 persona. Aleks Çoba 48 vjeç, banues në fshatin Rusan në Delvinë, u arrestua pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar për vjedhje në shuma të mëdha parash deri në 400 mijë euro në Greqi. Gjithashtu, po gjatë kontrolleve u kap dhe Dritan Hyseni 19 vjeç, banues në Sarandë, pasi gjatë kontrolleve fizik dhe të mjetit me të cilin qarkullohet pa leje drejtimi u konstatua një sasi lëndë narkotike në total 37.1 gr kokainë.





Raporti i Bankës së Shqipërisë

Familjet me kredi, 30% e të ardhurave shkojnë për shlyerjen e kësteve

Gati një e treta e familjeve shqiptare kanë një hua për të shlyer, kryesisht ndaj bankave. Banka e Shqipërisë gjatë një anketimit me rreth 1200 familje në të gjithë vendin për testuar qëndrueshmërinë e tyre financiare gjeti se në tremujorin e dytë të 2018 këstet mujore për shlyerjen e huave në familje zënë 10 deri 30 për qind të të ardhurave mujore. Sipas vërtetimit rreth 28% e familjeve deklaruan

se kanë hua për të paguar dhe kjo peshë ka mbetur e njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë, por nën mesataren historike të vlerave të vërtetimit. Rreth 60% e familjeve huamarrëse deklarojnë se "aftësia e tyre paguese" nuk ka ndryshuar, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë kryesisht përkeqësim krahasuar me 6-mujorin



paraardhës dhe një vit më parë. Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe i shpenzimeve të familjeve është rritur gjatë periudhës së vërtetimit, por rritja e shpenzimeve ka qenë më e theksuar, duke rezultuar në ngushtim të balancës financiare (të ardhura - shpenzime). Sipas analizës së Bankës, kjo strukturë ka vijuar të zhvendoset në favor të huamarrjes formale, krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më

parë. Në përbërjen e tepricës sipas monedhës, rezultoi se 84% e saj deklarohet në lekë dhe 16% në euro. Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 35% e tepricës së huasë deklarohet për blerjen ose riparimin e një prone, 41% për zhvillimin e një biznesi dhe vetëm 5% për konsum. Gjatë periudhës së vërtetimit, teprica e huasë me qëllim zhvillimin e një biznesi ka qenë në rritje, ndërsa për dy zërat e tjerë ka rezultuar në rënie. Familjet huamarrëse vlerësojnë rënie të kështit të huasë gjatë periudhës referuese,

duke reflektuar prirjen rënëse të normës së peshuar të interesit të kreditit për individët. Për gjysmën e dytë të vitit 2018, shumica e familjeve huamarrëse (rreth 74%) nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të të përgjigjurve tregon për një përkeqësim të lehtë. Mundësia për të marrë hua gjatë pjesës së dytë të vitit 2018, vlerësohet pothuaj e njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por në rënie krahasuar

Ministria e Financave ka publikuar treguesit fiskalë të 8-mujorit të vitit 2018 ku rezultoi se të ardhurat janë 9 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritjen më të madhe rezultoi se e kanë pasur të ardhurat nga Renta Minerare me 17.5% dhe Tatimi mbi të Ardhurat Personale me 14.2%. Sa i përket ndikimit të rënies së kursit të këmbimit të monedhave të huaja kundrejt monedhës vendase, efekte kanë qenë të ndjeshme në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja në import për të gjitha kategoritë e mallrave.

TË ARDHURAT

Të ardhurat totale për 8 mujorin 2018, u realizuan në vlerën 294 miliardë lekë, me një rritje 3% ose 9 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 99%. Të ardhurat e arkëtuara nga "tatimet dhe doganat" (përfshirë kontributet e mbledhura nga D.P.T) për 8 mujorin 2018, janë 259 miliardë lekë, 4.3% ose 10.7 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 99.6%. Të ardhurat nga "Taksa Doganore" janë realizuar në vlerën 4 miliardë lekë, me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 96.2%. Të ardhurat nga "Akcoza" janë realizuar në vlerën 29.7 miliardë lekë, me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 98%. Ndikim ka pasur "Karburanti" (import+prodhim vendas), që rezultoi rreth 384,075 ton, me një rritje prej 2,897 ton ose +0.8% krahasuar me 8 mujorin e vitit 2017. Gjithashtu, performancë pozitive si rezultat i rritjes së sasisë së shënuar: importi dhe prodhimi i "Birrës" +2.4%; importi i "Duhanit" +4.9%; importi i "Vaj lubrifikant" +6.3%; importi i "Kafes" +8.4%. Deklarimi i prodhimit vendas të duhanit është rritur nga 7 ton në 13 ton të deklaruar në periudhën janar-gusht 2017. Të ardhurat nga "Renta Minerare" në eksport janë realizuar në vlerën 1.8 miliardë lekë, me një rritje 17.5% ose 269 milionë lekë më shumë krahasuar me 8 mujorin e vitit 2017. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur, si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar dhe si

Treguesit fiskalë të 8-mujorit 2018, të ardhurat shtohen 3%

Ministria e Financave: Të ardhurat, 9 mld lekë më shumë Kursi i këmbimit uli të ardhurat nga TVSH-ja



rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur me 230 milionë lekë, si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar me rreth 81 mijë ton dhe janë rritur me 280 milionë lekë si rezultat i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 2.85 lekë/kg në 3.54 lekë/kg. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralat e eksportuara kanë pësuar rënie në masën 115 milionë lekë për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, me rreth 297 mijë ton si dhe janë ulur me 126 milionë lekë, për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet

ndërkombëtare, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të ardhurat nga "TVSH-ja" në total, janë realizuar në vlerën 93.3 miliardë lekë, me rritje 4% ose 3.5 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2017 dhe me realizim në masën 98.8% të planit. Rritja e importit të karburantit ka ulur prodhimin vendas të këtij produkti dhe si rrjedhojë të ardhurat nga TVSH-ja brenda vendit. Karburanti import mbuloi rreth 87% të konsumit gjatë periudhës Janar-Gusht të vitit 2018 krahasuar me 69% që ishte ky tregues vitin e kaluar. Rënia e kursit të këmbimit të monedhave të huaja (EURO dhe USD) kënddrejtë monedhës vendase, ka dhënë, gjithashtu, efekte të ndjeshme negative në uljen e

të ardhurave nga TVSH-ja në import për të gjitha kategoritë e mallrave. Janë rimbursuar rreth 9.2 miliardë lekë, 12.6% ose 1 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2017. Të ardhurat nga "Tatimi mbi Ftitimin" janë realizuar në vlerën 21.7 miliardë lekë, me rritje 3.1% ose 658 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Situata energjetike e vitit të kaluar ka dhënë efekte negative në rezultatit financiar të kompanive të sistemit energjetik, çka u reflektua në uljen e fitimit të tatueshëm dhe tatimit të paguar në vitin 2018. Të ardhurat nga "Tatimi mbi të Ardhurat Personale" janë realizuar në vlerën 25.1 miliardë lekë, me rritje 14.2% ose 3.1 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2017 dhe +2.9% ose 706 milionë lekë më shumë krahasuar me planin. Krahasuar me 8-mujorin e vitit të kaluar, të ardhurat nga të punësuarit e sektorit publik dhe sektorit privat, janë rritur ndjeshëm, kjo si rezultat i rritjes së numrit të kontribuesve aktiv krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tatimet: Karburantet dhe ndërtimet, subjekt i kontrolleve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në analizën e treguesve të performancës për periudhën janar - gusht 2018, ka konstatuar se tatimpagues, veçanërisht ata që operojnë në sektorin ekonomik të ndërtimit dhe tregtimit të karburanteve, kanë deklaruar ulje të qarkullimit. Kjo do të thotë se niveli i mospërbushjes tatiimore nga tatimpaguesve të këtyre sektorëve është në nivele jo të duhura. Nisur nga ky konstatim, DPT, njëfonton se këta tatimpagues do të jenë objekt i vizitave fiskale. Administrata tatimore bën me dije se nuk do të tolerohet asnjë shkelje e ligjit. Ndaj në mbështetje të këtij qëndrimi, tatimpaguesit, ftohen që të korrigjojnë vetëdeklarimet. "Në asnjë rast qëllimi i administratës tatimore nuk është vendosja e penaliteteve, por përbushja vullnetare e detyrimeve që ngarkohen nga legjislacioni në fuqi"- shkruhet në njoftimin e Tatimeve.



SHPENZIMET

Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e tetë të vitit 2018, arritën në rreth 289.7 miliardë lekë, me një rritje prej 1.9 përqind ose rreth 5.54 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 dhe me një realizim në masën 98.1 përqind të planit të periudhës. Shpenzimet korrente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim optimal, respektivisht në masën 98.5 përqind dhe 96.6 përqind të planit të periudhës. Shpenzimet korrente për periudhën 8 mujore të vitit 2018 rezultuan në rreth 250.1 miliardë lekë, ndërsa krahasuar

me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 1.4 përqind më i lartë ose rreth 3.6 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet kapitale për muajin e tetë të vitit 2018 paraqesin një realizim në masën rreth 39.6 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ky zë është 13.5 përqind më i lartë ose rreth 4.7 miliardë lekë më shumë. Niveli i suficitit në muajin e tetë të vitit 2018 rezultoi në rreth 4.08 miliardë lekë, ose rreth 3.98 miliardë lekë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë ku niveli i suficitit rezultonte në 101 milion lekë.

**Njoftim për shitje me ankad te dyte**

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e dorëzuesin K.S të ndodhura në Fanahore Mallakaster, Pasuria që shitet në ankad përbëhet nga :

Pasuria "Ara" me nr. 208/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869 Mallakaster me çmim 840.000 lekë. Pasuria "Ara" nr.208/7 me vol 4, faqe 2/41, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869 Mmallakaster, me çmim 56.000 lekëPasuria" me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 dhe ndodhet në Mallakaster me çmimin në masën 280,465 lekë

Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet të 18.10.2018 në orën 15:00 në "Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra 5, Kont. tel. 672082543, e-mailit llir\_dervishi@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

**Xibri: Nëse s'ka dakordësi, s'do ketë kthim pas**

**Mosmiratimi i statusit, minatorët tentojnë të hyjnë në Kryeministri**

Një grup minatorësh dhe përfaqësues të sindikatave kanë kërkuar dhe të hyjnë në Kryeministri në shenjë proteste për shkak të mosmiratimit të statusit të minatorit. Disa prej tyre kanë hyrë më pas në kryeministri dhe janë takuar me stafin e kryeministrit Edi Rama për gjetjen e një zgjidhjeje. Pas takimit Fiqiri Xibri, kreu i sindikatës së minatorëve 1991 informoi për rezultatet. Ndërsa fillimisht deklaruan se nga e hëna do nisnin radikalizimin e protestës, Xibri tha pas takim-

it në kryeministri se është shtyrë protesta pasi kanë rënë dakord që të mërkurën të zhvillojnë një takim me kryeministrin dhe ministrat e linjës për çështjen e tyre. "Diskutim për mosveprimet e deritanishme të qeverisë. Nuk janë bërë hapat e nevojshëm për statusin e minatorit dhe mundësitë që janë për ta përfunduar në afatin minimal të mundshëm. U diskutua që afati minimal është me

buxhetin e vitit të ardhshëm, por koha që ka mbetur është koha e duhur për të miratuar aktet e nevojshme. U diskutua me stafin e ngushtë të kryeministrit me dijeninë e tij. Na thanë se të mërkurën do bëjmë një takim të madh të përfaqësuesve të minatorëve me kryeministrin dhe të gjithë ministrat e linjës. Do diskutohet drafti i tyre i dakordësuar, por që është mbajtur peng për shkak të mos vlerësimit të

kostos. Të mërkurën do diskutohet drafti që është propozuar që më parë dhe që është dakordësuar edhe me konfederatën e sindikatave. Nëse të mërkurën nuk na pret me kryeministri dhe nuk ka dakordësi atëherë s'ka më kthim prapa, dy duar për një kokë", deklaroi Xibri. Pas takimit drejtori i komunikimit në Kryeministri Endri Fuga tha se po vazhdon puna për gjetjen e një zgjidhjeje përfun-



dimtare. "Komunikimi me përfaqësuesit e minatorëve vazhdon, njësoj siç vazhdon puna për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe përfundimtare. Angazhimi i Kryeministrit maksimal", shkruan Fuga.

Infermieri me inicialet M.L. denoncon rastin në polici. Reagon shoqata: Institucionet heshtin

**Dhunohet infermieri në QSUT, familjari i pacientit e kërcënon me jetë**

*Elson Jaçaj: Arsyet e konfliktit ishin banale*

Voltiza Duro

Në orët e para të mëngjesit të ditës së djeshme, një prej infermierëve të reanimacionit qendror në QSUT është dhunuar nga familjari i një prej pacientëve të shtruar. Infermieri me inicialet M.L. punonjës në këtë spital është konfliktuar me familjarin e pacientit, në momentin e ndërrimit të turnit. "Konflikti ka ndodhur në orët e para të mëngjesit gjatë ndërrimit të turneve ku në një moment një familjare ka hyrë brenda ambienteve të reanimacionit qendror në QSUT (që nuk është e lejueshme) dhe i kishte vajtur në dhomën e zhveshjes infermierit M.L. që kishte qenë në shërbim turni i tretë ku e kishte kërcënuar e më pas konfliktuar me duar", -thotë për 'Gazeta Shqiptare', Elson Jaçaj, kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë. Sipas këtij të fundit arsyet e konfliktit kanë qenë banale, pasi familjarja ka kërkuar të rrijë në dhomën e pacientit, e i ka kërkuar shpjegim infermierit mbi mungesën e medikamenteve. "Po i ndodhi gjë njeriut tim do ju vras të gjithëve, gjeni vend e futuni!", -kanë qenë këto fjalët e familjarit të pacientit. Më pas infermieri ka njoftuar shërbimin e policisë të rajonit nr 4 ku ka bërë kallëzim penal pasi është dhunuar gjatë ushtrimit të detyrës dhe në vendin e punës, në orar të punës.

**REAGIMI**

"Të shërbesh në kushte skandaloze i rrezikuar nga çdo lloj infeksioni e nën një presion psikologjik gjithë kohës tashmë nuk mungon as dhuna. Aty ku shpëtohet jetë dhe ku luftohet me jetën. Ku infermierë dhe mjekë në luftë me kohën mundohen t'i japin shpresë



Elson Jaçaj, kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë

dhe jetë kujtdo që shkon në duart e tyre. Atyre që i beson jetën e në fund sërish i dhunon. Sigurisht që jo çdo betejë me jetën mund të fitohet por ju garantojmë se në asnjë rast nuk është faj i stafit mjekësor për këtë, por mungesa e medikamenteve dhe aparatave që duhen për këto paciente", -thekson Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë. Kjo e fundit shton se pavarësisht rasteve të shtuara të dhunës ndaj bluzave të bardha, institucionet përgjegjëse kanë zgjedhur të heshtin. "Sikur të mos mjaftojnë arsyet e shumta për t'u larguar nga vendi tashmë me këtë fenomen kanë një arsye më të fortë të gjithë infermierët", -thotë Jaçaj. Më tej

Shoqata e infermierëve të Shqipërisë i ka bërë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Urdhrit të Infermierëve të Shqipërisë; Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë; Avokatit të Popullit e çdo institucioni përgjegjës që të marrin masa të menjëhershme jo vetëm për rastin konkret por dhe në parandalimin e këtij fenomeni që po rritet ditë-ditës. "I bëjmë thirrje mjekëve dhe infermierëve të solidarizohen të gjithë bashkë kundër diskriminimit që po u bëhet figurës dhe punës së tyre. Mos prit dhe ti të jesh i dhunuar që të reagosh, sepse nëse hesht sigurisht nesër do jesh ti i dhunuari i radhës", -thekson Shoqata.




**REAGIMI**

"Të shërbesh në kushte skandaloze, i rrezikuar nga çdo lloj infeksioni e nën një presion psikologjik gjatë gjithë kohës, e tashmë nuk mungon as dhuna. Aty ku shpëtohet jetë dhe ku luftohet me jetën. Ku infermierë dhe mjekë në luftë me kohën mundohen t'i japin shpresë dhe jetë kujtdo që shkon në duart e tyre. Atyre që i beson jetën e në fund sërish i dhunon.

**Zjarret në vend, Xhaçka: 91 vatra, përgjegjësit para ligjit**

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka dalë dje para mediave për të informuar mbi situatën e zjarreve, por edhe për të paralajmëruar përgjegjësit. Ajo tha se për 17 ditë ka pasur 91 vatra zjarri dhe se është ndërhyrë me helikopterë "Cougar". Xhaçka deklaroi se mbrojtja dhe reduktimi i faktorëve të Emergjencave Civile, (në këtë kuadër edhe zjarret), është ndër prioritetet e qeverisjes së vendit. "Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e



Emergjencave Civile organizon punën me strukturat e pushtetit vendor për të marrë masa për përbalimin e situatës së zjarreve gjatë

muajve të verës. Risia e masave të marra për organizimin gjatë këtij viti ishte edhe pajisja e helikopterëve "Cougar" me kova me kapacitet 2500 litra ujë secila për shuarjen e zjarreve. Testin e parë real këto mjete e patën në shuarjen e zjarrit në pyllin e Semanit dhe rezultati ishte ai që prisnim. Ndërhyrja ishte efiçase dhe zjarret u arritën të dominoheshin plotësisht dhe në një kohë shumë të shkurtër", deklaroi ministria.

## KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" DIPLOMIMI

Rektori: Falënderime për "Hysenbelliu Group"! Themeluesi Aleks Luarasi: Jemi krenarë

Voltiza Duro

Kolegji Universitar "Luarasi" diplomoi brezin e 14-të të studentëve ditën e djeshme, çka përkonte edhe me datën e themelimit të tij, 15 vite më parë. Plot 200 juristë dhe ekonomistë të rinj të veshur me rrobën akademike nuk mund t'i fshihnin emocionet. I krijuar në vitin 2003, "Luarasi" si institucion lider i dijes dëshmoi edhe njëherë se ka të gjithë potencialin për të përgatitur breza të denjë profesionistësh, të cilët kanë në duar një dokument, i cili u jep siguri për një karrierë të shkëlqyer dhe që premtim shumë. Fytyra të buzëqeshura, emocione të pafundme e madje edhe lot gëzimi shoqëruan mbrëmjen e së premtes në oborrin e Kolegjit Universitar "Luarasi", ku studentët e ciklit Bachelor dhe Master festuan diplomimin e tyre në një ceremoni madhështore. Në këtë event të rëndësishëm ishte i pranishëm edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erjon Veliaj; themeluesi i këtij institucioni elitari, Dr. Aleks Luarasi si dhe presidenti i "Hysenbelliu Group", z. Irfan Hysenbelliu. Gjithashtu, në ceremoni ishin të pranishëm edhe personalitete të shquara, që prej vitesh kanë bashkëpunuar me "Luarasin" nga fusha e drejtësisë dhe e botës së biznesit.

### FJALA E HAPJES

Rektori i këtij universiteti, Prof. Dr. Ethem Ruka mbajti fjalën e hapjes së kësaj ceremonie madhështore dhe theksoi se kjo është një datë e veçantë për studentët si dhe stafin akademik. "Kjo ditë e ceremonisë së diplomimit në Universitetin "Luarasi" përkon edhe me datën e themelimit të tij. Është një ditë e veçantë për 200 studentët si dhe trupën akademike që ka punuar me dashuri e përkushtim, për ata që punuan për rritjen e "Luarasit", si dhe për prindërit që na besuan fëmijët maturantë e sot ne ua kthejmë si profesionistë", - theksoi Ruka në fjalën e tij. Më tej, Ruka falënderoi kryebashkiakun Erjon Veliaj, ish-rektorët e "Luarasit" si dhe të gjithë pedagogët që kanë qenë pjesë e këtij institucioni. Një falënderim i veçantë nga rektori ishte për drejtuesit e "Hysenbelliu Group", si dhe presidentin, z. Irfan Hysenbelliu. "Këtë vit të ri akademik, studentët mund të studiojnë në fakultetin më të ri, atë të Teknologjisë së Informa-

# Ceremonia madhështore, "Luarasi" diplomon brezin e 14-të të studentëve

*Erion Veliaj: Urimet më të mira për të sapodiplomuarit*



Kryebashkiaku Erion Veliaj me presidentin e "Hysenbelliu Group", Irfan Hysenbelliu dhe Zëvendëspresidentja e "Hysenbelliu Group", Fabiola Hysenbelliu

### ERION VELIAJ

"Unë dua që t'ju uroj të gjithëve shumë sukses! E di që studioni për shumë lëndë që ndoshta ka inflacion, por asnjëherë nuk ka inflacion për ata që arsimohen. Edhe në juridik, ndonëse ka shumë që diplomohen, ka gjithmonë vend për më të mirët. Ndaj u them miqve të mi studentë, mos u shqetësoni që në këtë treg ka plot të tjerë, por përpiquni që të jeni më të mirët. Dhe unë jo vetëm që jam krenar për ju sot, si prindërit dhe profesorët tuaj, por jam edhe fansi juaj më i madh", u shpreh kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

cionit dhe Inovacionit. Vepërimtaria mësimore e "Luarasit" përkon pothuajse me të gjithë periudhën në të cilën ka kaluar arsimiti i lartë në Shqipëri. Nuk ka asnjë dy-

shim që 'Luarasi' është udhëhequr nga profesionalizmi", - shtoi Ruka.

### FJALA E KRYEBASHKIAKUT

Sakaq, kryebashkiaku i

Tiranës, Erion Veliaj ka përcjellë mesazh urimi për të rinjtë e "Luarasit" që diplomohen, ndërsa ka shprehur mirënjohje për prindërit e tyre dhe pedagogët e "Luarasit". "Të gjithë prindërit janë këtu dhe kjo tregon shumë. Dua të them se pa ju atje, nuk do të ishin këta këtu. Kjo është një shkollë private dhe jo të gjithë do të kishin mundësi të ishin në një shkollë të tillë, me kushte të tilla dhe profesorë të këtij niveli. Ndaj them se u jemi shumë mirënjohës të gjithë prindërve. Po kështu u jemi mirënjohës mësimdhënësve, jo ata që vijnë për atë rrogën, për 8-orëshin, por

### ALEKS LUARASI

"Shpreh urimet më të mira për diplomimin tuaj dhe ju uroj sukseset më të mira për të ardhmen! Ju e kaluat me sukses këtë rrugë të vështirë, jemi krenarë për gjithçka që keni arritur deri tani. Kjo ceremoni ka një kuptim të dyfishtë: si ceremoni diplomimi dhe përkujtimi. Rritja e universitetit "Luarasi" në vite ka qenë graduale, e menduar dhe e përgatitur më parë", - theksoi Luarasi.

e kam fjalën për ata që bëhen mentorë, që kujdesën për botën tënde shpirtërore, që të bëhen si vëllezër. Kjo është ajo që ndihmon për të ardhmen e gjeneratës sonë", - tha Veliaj. Ky i fundit më tej ka shprehur urimet më të përzemërta për studentët e "Luarasit". "Unë dua që t'ju uroj të gjithëve shumë sukses! E di që studioni për shumë lëndë që ndoshta ka inflacion, por asnjëherë nuk ka inflacion për ata që arsimohen. Edhe në juridik, ndonëse ka shumë që diplomohen, ka gjithmonë vend për më të mirët. Ndaj u them miqve të mi studentë, mos u shqetësoni që në këtë treg ka plot të tjerë, por përpiquni që të jeni më të mirët. Dhe unë jo vetëm që jam krenar për ju sot, si prindërit dhe profesorët tuaj, por jam edhe fansi juaj më i madh", u shpreh kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

### THEMELUESI I "LUARASIT"

15 vjet më parë "Luarasi" ishte vetëm një ide dhe një projekt i juristit të njohur, profesor Aleks Luarasi, i cili sot ka një kontribut esencial në strukturimin e universitetit. Themeluesi i "Luarasit" u shpreh se tradita e konsoliduar e universitetit vazhdon e përforcohet çdo vit e më shumë. "Shpreh urimet më të mira për diplomimin tuaj dhe uroj sukseset më të mira për të ardhmen! Ju e kaluat me sukses këtë rrugë

të vështirë, jemi krenarë për gjithçka që keni arritur deri tani. Kjo ceremoni ka një kuptim të dyfishtë: si ceremoni diplomimi dhe përkujtimi. Rritja e universitetit "Luarasi" në vite ka qenë graduale, e menduar dhe e përgatitur më parë", - theksoi Luarasi. Themeluesi i këtij institucioni elitari shtoi se shumë studentë të "Luarasit" kanë arritur të punësohen jashtë Shqipërisë falë kësaj diplome.

### DIPLOMIMI

Gjatë ceremonisë u ndanë edhe medalje nderi dhe certifikata për ata që kanë spikatur me dijet e tyre dhe me siguri do të jenë liderët e së ardhmes. Medalja e nderit u dhua nga kryebashkiaku Erion Veliaj, ndërsa certifikatë për studentët e ekscelencës nga Zëvendëspresidentja e "Hysenbelliu Group", Fabiola Hysenbelliu. 200 të diplomuarit e drejtësisë dhe ekonomikut mezi kanë pritur të fluturojnë kapelat e tyre mes emocioneve të rralla, duke mbyllur kështu një cikël të rëndësishëm të jetës. Me hedhjen e kapelave akademike të brezit 14 të diplomuarve, "Luarasi" shkroi sërish historinë. Vetë studentët janë shprehur tejet të lumtur që tashmë mbajnë në duar një diplomë që do t'u hapë dyert për të ardhmen profesionale. "Jam shumë e lumtur që jam diplomuar te "Luarasi", stafi ka qenë profesionist dhe kurrikula bashkëkohore. Investimi më i mirë që kam bërë në jetën time", - tregon një prej studentëve të sapodiplomuar. Një tjetër student tregon se gërshtimi i praktikës me teorinë është një nga armët më të forta të këtij universiteti. "Ndihmë shumë i kënaqur që kam qenë pjesë e "Luarasit", një universitet me një staf akademik të shkëlqyer, që gërshton praktikën me teorinë. Besoj se shumë shpejt e ardhmja ime do të ndryshojë", - tregon studentin.



Gjatë ceremonisë së diplomimit në Kolegjin Universitar "Luarasi"

## ARKITEKTURA E KISHAVE TË SHQIPËRISË

# Trishtimi i Shën Barbarës

## Gjendja e mjerueshme e kishës së shekullit të XIII në Pllanë

Fatmira Nikolli

**N**gjyrat e afreskëve të dy shenjtoreve në dy anët derës së kishës, janë të zbehta. Fytyra e Shën Gjergjit mbi kalë është e dëmtuar, me gjasë nga pushtimet siç ka ndodhur rëndom nëpër vendet e pushtuara nga Perandoria Osmane ku shenjtëve u 'nxirreshin' sytë. Ndërsa Shën Mëhilli (Engjëlli Mikael) me aureolën mbi krye dhe krahët e engjëllit është i plotë në figurën e vet dhe në mesazhin e vet, teksa vë përfund djallin. Anash strukturës ku gjenden afresket shihen ndërhyrje konservuese e konsoliduese të murit. Nga kodra e Pllanës ku ndodhet kisha sheh lumin Mat dhe urën e Zogut. Fshati gjendet mes Milotit e Lezhës, pak minuta nga rruga kryesore. Rruga deri lart në fshat është e shtruar, ndërsa nga fshati deri lart në kishë, në varrezat e të cilës ende prehen të ikurit e fshatit, është pothuaj një shteg. Në oborrin e saj ende u jepen bekimet e fundit atyre që ndahen nga kjo jetë ndaj, dera e drunjtë e kishës është e hapur.

Brendia e kishës është imazhi i një trishtimi të pa skaj. Altari mbi të cilin muralet me ngjyra jepnin ske-na biblike të krijuar veçse një imazh të asaj që ka qenë. Copa muresh bien, bashkë me bojën blu të një qielli të mundshëm. Dëmi i kohës ka qenë aq i madh sa nuk kuptohet më për cilën skenë biblike bëhet fjalë. Copat e mureve të rëna kanë zënë vend në dyshe, ndërsa tavani me dërrasa nuk është i plotë. Në fund të kishës, në zonën e korit në dy anët e derës, afreske të tjera po zhbehen. Në to, shihen edhe gjurmë studimesh të kryera, për aq sa të lejon që drita që depërton nga dritaret e vogla. Tetë vite më parë, ajo ruante më shumë ngjyra se tani, ku duket se dorëzimi po bëhet i pashmangshëm.

## STUDIUMI

Në librin e Aleksandër Meksit "Arkitektura e

kishave të Shqipërisë shk.VII-XV" vë në dukje se kisha e Pllanës njihet nga vendasit si kisha e Shën Barbarës apo Barbullës. Përbëhet nga naosi e një hajati i vonë, i ndërtuar me tulla të shekullit tonë që duket se kanë zëvendësuar një më të hershëm, të cilin na e kumton në vitin 1610 Marin Bici,

kallëve. Një portë tjetër është në anën veriore mbuluar me hark gjysmërrethor.

Meksi vëren se salla përbëhet nga një vëllim unik, i mbuluar me çati druri e tavan dërrasash dhe përfundon në anën lindore me një absidë gjysmërrethore. Salla ndriçohet nga katër dritare të larta e të ngushta në

raturës. Në murin lindor të kishës del absida gjysmërrethore. Ajo nuk ka dritare dhe përfundon në pjesën e poshtme me një mur.

Si në murin verior ashtu edhe në atë jugor duken qartë për nga ndryshimi i muraturës, fugat e takimit të hajatit të vonë me murin e ri të kishës. Po kështu në anën veriore ruhen pjesë të mureve të një ndërtimi shitesë që i është bërë kishës", - thotë profesori. Sipas tij, arkitektura e kishës paraqitet



e thjeshtë, siç janë përgjithësisht kishat e kësaj zone. Për datimin e saj ajo nuk ofron asnjë të dhënë. Nga ndërtimi planimetrik e teknika e

ndërtimit mendojmë se i takon shekujve XIII-XIV duke pasur parasysh dhe përmendjen e në shek XVI si ndërtim i vjetër.



si një hajati i bukur para kishës. Meksi shënon se B.Orsini e quan si më të bukurën e Shqipërisë, ndërsa më vonë në vitin 1664, M.Skura e cilëson si kishë të peshkopatës së Krujës të cilën e ka rrëmbyer ajo e Lezhës. Në hajati ruhen dy afreske pasbizantine, në të djathtë dhe në të majtë të hyrjes për në kishë, ndërsa në brendësi në murin perëndimor, anash hyrjes janë dy afreske të stilit të protorenesancës.

Në sallë hyhet nga porta në murin perëndimor, nëpërmjet katër këmbë sh-

anën jugore. Ato mbulohej me hark të rremë, të gdhendur në një gur të skuadruar. Po me gurë të skuadruar, janë edhe shpatullat e dritareve. Në anën e jashtme kisha është trajtuar thjeshtë, me mure të rrafshëta që përfundojnë me një kornizë prej rrasash guri të të nxjerra pak ndaj faqes së murit e të profiluara lehtë. Muret janë ndërtuar me gurë të rregullt gëlqerorë e shtufi, të lidhur me llaç gëlqereje me mbushës të ashpër. Në murin jugor të kishës janë dy radhë të rregullta vrimash të brezave të drunjtë të mu-



## Fibank Albania hap degën në Lushnjë

**Fibank** po zgjerohet në tregun shqiptar me mbështetjen e fuqishme të Grupit rajonal **Fibank**. Strategjia e zgjerimit synon kredidhënien dhe suportin për bizneset e mira, punësimin e kapaciteteve profesionale si edhe ofrimin e të gjitha produkteve e shërbimeve bankare për klientët individë.

**Fibank Albania** është në vazhdimësi të zhvillimeve pozitive dhe të rritjes së mëtejshme e bazuar në përpjekjet e vazhdueshme në ofrimin e produkteve inovative dhe të përshtatura për çdo tip klienti.





# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 629

SUPLEMENT I PERJAVSHEM

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 29 Shtator 2018



## PRITEJ DASHMA STRESI & KEJSI NUK JANE ME BASHKE


*I japin fund lidhjes? Detajet që tregojnë se këngëtari është ndarë nga e dashura. Shfaqi dokumentin e celebrimit, ç'po ndodh me çiftin e njohur shqiptar?*

### EVİ REÇİ:

SE SHPEJTI NË  
"TOP CHANEL"?  
RREFEHET  
KENGETARJA: JA  
KUR DO TE ME SHIHNI



### MANIA E OPERACIONEVE I THANE "JO" NATYRALES, VIP-at QË BENE NDERHYRJE



## “S’më paguajnë sa në Top”, aktori zbulon arsyen pse hoqi dorë nga “Portokalli”

Në ndryshimet dhe flukset e tepërta të merkatos televizive ishte edhe aktori i “Portokalli” Olsi Bylyku. Ai u largua nga spektakli i humorit “Portokalli” në “Top Channel”, për të kaluar tek “E Diela Shqiptare” në “Tv Klan”. I ftuar në emisionin “Trokit” Olsi tregoi disa detaje lidhur me “B.E Caffè”, ku do të jetë krahas kolegëve Bes Kallaku dhe Erion Isai. Përgjatë intervistës ai tha se arsyeja e largimit nga “Portokalli” nuk ka lidhje me pagesën, por dëshirën për të punuar me Besin dhe Erionin. “Nuk jam më i shtrenjtë sesa në Top. Jam aty-aty. Kam shkuar në Klan afërsisht me të njëjtën pagesë që kisha në Top. Nuk kam shkuar me një blerje të madhe. Nuk ka qenë kusht pagesa. Unë, Besi dhe Erioni kemi një punë që e bëjmë për të mirën e emisionit. Ndikimi monetar nuk ka qenë absolutisht fare. Ne thjesht kemi dashur të punojmë të tre. As unë, as Besi as Erioni nuk kemi pagesa marramendëse”, -u shpreh Olsi. Tre aktorët do i shohim së shpejti në transmetim së shpejti dhe me siguri do të kemi të geshura pafund!



## Tani s’e mohojnë dot! Foto, Marina dhe Luana shfaqen së bashku me partnerët

Disa detaje nga dasma e Ledionit dhe Sarës u zbuluan me kohë dhe një ndër to ishte edhe prania e Krenar Çoçaj si shoqëruues i Luana Vjollcës. Dhe kjo u zbulua falë bashkëshortit të Marina Vjollcës, këngëtarit Getoar Selimi, i cili shpërndau një foto bardhë e zi në profilin e tij në “Instagram”, ku shfaqej krahas kunatit të tij Krenar Çoçaj. Ama, nuk pamë në asnjë moment një foto të çiftit të shumëpërfolur apo edhe një foto ku familja ishte e bashkuar! Më në fund, një foto e tillë ekziston! “Prive.al” ka publikuar momentin gjatë ceremonisë së betimeve, ku shfaqen të ulur bashkë dy çiftet, Getoar Selimi me Marinën dhe Krenar Çoçaj me Luanën. Tanimë, s’kanë se si ta mohojnë të dy tashmë. Kemi edhe prova!

## Pritej të dilte me Gencin, por Eni Koçi ‘preferon’ dikë tjetër tani

E dhe pse në postimin e fundit të bërë, këngëtarja e njohur, Eni Koçi paralajmëroi se do të sillte një tjetër duet me Genc Prelvukaj, me të cilin edhe përfillet se ka një lidhje prej kohësh, ajo solli një tjetër bashkëpunim. Eni Koçi dhe Besnik Qaka sjellin këngën ‘Zemër’.

Në një prodhim të Genc Prelvukaj, dyshja Eni Koçi dhe Besnik Qaka, solisti i grupit NRG Band kanë publikuar bashkëpunimin e tyre. Kënga me titull ‘Zemër’ vjen me një videoklip të bukur të realizuar nga BlackFish Entertainment. E ndërsa Eni ka paralajmëruar se ajo shumë shpejt do të vijë me një bashkëpunim tjetër me Gencin, të tretin me radhë nga dyshja. Të shohim ç’suprizë na rezervon çifti!



## Rikthehet Klea Huta, ja me kë do të bëjë ‘garë’ në ekran

Vera mbaroi, por ne ende s’kemi mbaruar listën e ndryshimeve të merkatos së medias për këtë vit! Klea ndryshe nga të tjerët, e bëri publike shpejt lëvizjen e saj Top Channel, madje pak kohë më vonë, edhe xhirimet e gramit ‘Top of the Top’, i cili do të nisë transmetimet së shpejti. Megjithatë vetë moderatorja publikoi pak javë më parë lajmin se program i ri do të jetë gati në shtator, në fakt, mendohet se ‘Top of the Top’ do të nisë transmetimet më 14 tetor. Por për detajet duket se është ende herët, por thuhet që Klea do të shfaqet të dielën në orën 17.00. Programi i përbashkët i së dielës, me Edi Manushin, Fjoralba Ponarin, Jonida Maliqin dhe Flori Gjinin, ka një hapësirë edhe për Klean. Ndërkohë, në të njëjtën orë në ekranin tjetër, Tv Klan, prej vitesh drejton rubrikën “Shihemi në gjyq” Eni Çobani – një prej pjesëve më të ndjekura. Ndërsa në Top, ‘Top of the Top’, programi me Klea Hutën do të vijë për 12 të diela me radhë. Intervista me shqiptarë të famshëm në Europë dhe Amerikë, të ftuar interesantë që ndajnë histori jete, por edhe shumë rrëfime të natyrave të ndryshme nga çdo anë e botës. Kush do të fitojë më tepër audiencë? Mbetet për t’u parë!



Huta, drejt pro-




I japin fund lidhjes? Detajet që tregojnë se këngëtari është ndarë nga e dashura

# Së shpejti do martoheshin, **Stresi** dhe **Kejsi** nuk janë më bashkë

*Shfaqji dokumentin e celebrimit, ç'po ndodh me çiftin e njohur shqiptar?*

Pamela Aliaj

Të gjithë i dinim se ishin martuar tashmë dhe se jeta e tyre private po shkonte për mrekulli. Kjo jo vetëm nga fotot dhe videot e postuara në 'Instagramin' e gjithsecilit, por edhe për shkak të dokumenteve që para pak kohësh i shfaqën duke e bërë zyrtare lidhjen e tyre. Por tashmë, mesa duket, Stresi dhe partnerja e tij, Kejsi, që prej tre vite e gjysmë jetojnë një histori dashurie, tashmë nuk janë më pranë njëri-tjetrit. Marrëdhënia e tyre ka kaluar nëpër shumë pengesa e megjithatë ata ja dolën mbanë të qëndronin pranë njëri-tjetrit. Pak kohë më parë Stresi dhe Kejsi zyrtarizuan lidhjen e tyre, duke u celebruar. Kjo u vërtetua edhe falë një dokumenti të cilin ishte vetë Kejsi që e postoi në rrjetet sociale ku shkruhej e zeza në të bardhë: Kejsi Lushaj. Pra, tashmë ishin burrë e grua! Por duket se çifti i njohur po kalon një krizë dhe gjërat mes tyre nuk po ecin siç duhet. Kjo është vënë re ngaqë Stresi dhe Kejsi kanë fshirë çdo gjurmë si çift nga 'Instagrami'. Jo vetëm kaq por ata nuk kanë



më asnjë fotografi së bashku dhe përveç kësaj Stresi nuk e ndjek më Kjesin në 'Instagram'. Të gjitha këto shenja mund të çojnë në mendimin se ata të dy janë ndarë. I pyetur për "Bluetooth" të Gazeta Shqiptare, këngëtari nuk ka dashur më të japë detaje nga jeta e tij private. Megjithatë

nuk dihet nëse ky është një vendim definitiv nga ana e të dyve apo thjesht një ndarje e përkohshme për shkak të problemeve që mund të kenë bashkë. Ndërkaq Stresi dhe Kejsi në një rrëfim ekskluziv të pak kohëve më parë për Revistën "Who" treguan se kishin në plan të bënin një

dasmë me familjarët e tyre, por për shkak të krisjes në marrëdhënie dasma e tyre mund të anulohet. Ata nuk kanë më asnjë fotografi së bashku dhe përveç kësaj Stresi nuk e ndjek më Kjesin në 'Instagram'. Edhe pse këngëtari nuk pranoi të fliste më gjatë lidhur me të vërtetën



e kësaj ngjarjeje, të gjitha këto shenja mund të çojnë në mendimin se ata të dy s'janë më me njëri-tjetrin. Megjithatë nuk dihet nëse ky është një vendim definitiv nga ana e të dyve apo thjesht një ndarje e përkohshme për shkak të problemeve që mund të kenë bashkë. Urojmë që kjo krisje të mos çojë në ndarjen e tyre definitive. Të shohim nëse së shpejti do të kemi papritur një dasmë apo vendimi nuk ka kthim pas.



Mania e operacioneve plastike, më mirë me apo pa to?

# I themi "Jo" natyrales, cilat janë **PERSONAZHET** e njohura që bënë **ndërrhyrje** *Si ishin e si janë, ndryshimet e fundit në pamje të VIP-ave*

Pamela Aliaj

*"Pasqyrë moj pasqyrë, cila është më e bukur... vajza me fytyrë engjëlli dhe trup plastik, apo natyralja me trup të shëndoshë e me hundë joperfekte?". Sa herë është bërë kjo pyetje nga vajzat kur shohin veten të reflektuar kudo që shkojnë? Perfektja? Idealja? Nuk besoj se një bisturi mund ta zgjidhë, por shumë prej nesh mesa duket (jo vetëm VIP-at) duket se gjejnë rehat në korrigjimin estetik të pamjes së tyre. Së fundmi, ndryshimet estetike, gjithmonë duke iu referuar VIP-ave, duket se kanë ndikuar në mënyrë të dukshme në jetën e tyre. Kush për mirë e kush për keq, kush me më shumë e kush me më pak ndërrhyrje, kanë shfaqur pasoja të menjëhershme në përditshmërinë e tyre. Të shohim disa të listuara më poshtë:*

## ARILENA zmadhon gjoksin, por "zhduket" nga "Instagram"-i

Edhe pse ajo ka qenë gjithnjë në plan të parë dhe gjithmonë më e vlerësuara për sa i përket pamjes së jashtme, këngëtarja e njohur Arilena Ara bëri së fundmi ndërrhyrje për zmadhimin e gjoksit. Me zmadhimin e gjoksit, ajo nuk po ndalet së publikuari imazhe provokuese në rrjete sociale, për të cilat edhe komentohet. E tillë është edhe kjo e fundit kur sjell një pamje natyrale të saj, por që i gjithë fokusi është tek gjoksi bombastik. Por ajo që na bën më tepër çudi tani është fakti se Ara vendosi të "zhdukej" për pak kohë nga "Instagram"-i. Të jetë kjo derivat i komenteve apo 'dikush' nuk është dakord me ekspozimin e saj të tepërt? Të shohim sa do zgjasë kjo shkëputje. Ndërkohë, kujtojmë se Arilena u kap 'mat' këtë verë së bashku me të dashurin e saj teksa po shijonin pushimet në jaht. Të jetë ai arsyeja? Ende s'e dimë!



## BIG MAMA gjen rehat më në fund me trupin e saj

Këngëtarja Big Mama, e cila njihet si këngëtarja me një rekord operacionesh në trup, më në fund gjeti rehatinë. Kjo gjë u dësh-mua pas operacionit të fundit, i cili u konsiderua si një ndër më të rrezikshmit, por që për Big Mamën ishte një tentim për të cilin nuk ka pasur aspak frikë. Pështja e saj tashmë është konstante dhe e bën një femër atraktive Bigun. Imazhet që publikon herë pas here po e nxjerrin në pah një femër shumë joshëse, sidomos fotoja e fundit, e cila tregon Bigun me tipare të jashtëzakonshme femërore. Bravo për guximin!





Jo më si këngëtare, por me një tjetër rol. Cili është ekranit që ka zgjedhur gazetarja

## Së shpejti në "Top Chanel"? Rrëfëhet **EVI REÇI**: Ja kur do të më shihni

Pamela Aliaj

Është përfolur prej kohësh se kushërira e motrave Vjollca tashmë do të ketë një tjetër rol në skenë. Atë s'do ta shohim më vetëm si këngëtare, por edhe si moderatore e një programi në "Top Chanel". Mesa duket, fama e motrave Vjollca i dha pak fat bukuroshes Reçi. Por ajo që s'duhet të harrojmë është se këngëtarja ka mbaruar studimet në Itali për gazetari si dhe është gazetare në një nga gazetatat më prestigjioze "La Repubblica". Kështu që kjo s'është aspak e paktë për të nisur këtë rrugëtim të ri në median shqiptare. Ndërkohë për të vërtetuar këto aludime të



dala nëpër media para pak kohësh, ne e pyetëm direkt Evin dhe ajo u përgjigj: "Është përhapur para kohe ky lajm dhe s'e di se si. Por realisht jam në bisedime e sipër dhe sinqerisht nuk është konfirmuar akoma diçka konkrete. Por edhe sikur, nuk bëhet fjalë për këtë sezon, por për atë tjetrin, nga marsi. Për momentin jam akoma në bisedime dhe s'kam mbyllur gjë me asnjë televizion. Nëse do kem diçka, patjetër që do jem e para që do e thotë"! Pra, me pak fjalë, nuk është e finalizuar që do të jetë në "Top Chanel", por një gjë e dimë me siguri: Evin do ta shohim në mars! Kështu, të gjitha ekranet e sytë nga këngëtarja për të parë risinë që do të sjellë!

## Vendosi edhe ANXHELA MARTINI? Komentuesit e "kryqëzojnë" për operacionet plastike

Bukuroshja me famë botërore Angela Martini është cilësuar gjithnjë si një bukuri e egër dhe sidomos natyrale, por mesa duket, nuk e ka më këtë status. Modelja së fundmi ka publikuar një foto në rrjetet sociale ku në fokus është portreti i saj. Por duket se pamja e saj ka bërë që komentuesit ta pyesin se çfarë ka ndryshuar dhe pse duket ndryshe. Ata e kanë pyetur modelen nëse ka bërë ndërhyrje, por ajo nuk ka kthyer asnjë koment. "Më duket mua apo je ënjtur nga fytyra, ndoshta ndonjë ndërhyrjeje, nuk i rezistove dot as ti." "Çfarë i ke bërë fytyrës tënde Angela", - shkruajnë komentuesit. Të jetë e vërtetë?



## XHESIKA POLO gjen vetveten me 'look'-un e ri

Xhesika Polo është një këngëtare mjaft e njohur në vend, e cila numëron një sërë këngësh në repertorin e saj muzikor. Me shumë kilogramë më pak këngëtarja nuk njihet me pamjen e re. Ajo ka vendosur t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje për heqjen e dhjamit, e cila e ka ndihmuar të arrijë format e dëshiruara fizike. Së fundmi, ajo është inspiruar nga fotot pa fotoshop të këngëtares Ronela Hajati dhe ka vendosur të ndjekë shembullin e saj. Buzë pishinës dhe e veshur me bikini, Xhesika ka 'përqafuar' kompleksin e saj trupore dhe ka ekspozuar foton e rrallë, ku i duken format trupore. "Askush nuk është perfekt! Duke u munduar të dukemi sa më ideale për sytë e publikut, harrojmë të jemi të vërtete... Kjo është një foto e vërtetë. Nuk paska gjë më të bukur se të jesh rehat në lëkurën tënde. (Shtysë për të postuar këtë foto mu bë Ronela Hajati me postimet e saj të fundit)", ka shkruar ajo në diçiturën e fotos. Tashmë me 'look'-un e ri, Xhesika ndihet vetvetja.



## Më në fund e kuptuam! Elgit Doda shpjegon kuptimin e tatuazhit të veçantë

Të gjithë e kemi parë përveçse talentit të tij edhe pasioneve që ka për tatuazhet. Kantautori i njohur Elgit Doda ka një tatuazh mjaft të veçantë në krah, kuptimin e të cilit e ka treguar përmes një postimi në rrjete sociale. Bëhet fjalë për dy shkopiinj instrumentale baterie, të cilat lidhen fort me muzikën. "Aty ku nisi gjithçka", - shkruan kantautori në foto ku tregon tatuazhin e tij. Pra, gjithçka ka nisur nga bateria! Ndërkohë që kujtojmë se Elgidi prej disa kohësh ai është në një lidhje dashurie me moderatoren e njohur Klea Huta me të cilën ndan edhe një tatuazh të përbashkët në dorë.



## Askujt s'ia priste mendja! Bleona tregon sakrificën e saj më të madhe në jetë

Të gjithë e njohim si këngëtarja që guxon gjithnjë në stil dhe në këngët e saj gjithnjë për të arritur qëllimin e vetëm: Famën! Bleona Qerreti, kohët e fundit u shfaq në një intervistë për emisionin "Lartë e Poshtë", e veshur me një peshqir të mbledhur në kokë, e një tjetër të hedhur rreth trupit! Këngëtarja tregoi se bëri këtë zgjedhje që njerëzit të mund të shihnin Bleonën e vërtetë. Mirëpo, gjatë intervistës ajo kërkoi që vëmendja të jetë tek mendimet, idetë dhe sakrificat që ajo ka bërë gjatë karrierës së saj muzikore.

"Sakrificat më e madhe është jeta private! Unë punoj 18 orë në ditë. Kujdesem për gjithçka, duke filluar nga veshja, make up-i, ndriçimi, tek kamerat, dritat, këndi i xhirimit, e më pas e gjithë puna spostohet në montazh. Normalisht që kam njerëz që më ndihmojnë, por

përgjegjësinë e të gjithë klipit e kam vetëm unë! Kjo është sakrificë! Pastaj njerëzit, i marrin gjërat ashtu siç ata duan. Por unë dua të kërkoj nga ju që të mos shikoni tani vetëm faktin se Bleona dha intervistën e veshur me një peshqir, por atë çfarë unë jam në të vërtetë." – tha Bleona Qerreti. Ndërkaq së shpejti Bleona pritet të publikojë me 5 tetor, këngën e saj më të re me titull "Monster".



## Nuk përmbahet më, del në shtrat i zhveshur me partneren këngëtarja shqiptar

Të gjithë e njohim jo vetëm për talentin e tij, por edhe për faktin se është i veçantë në llojin e tij dhe gjithnjë del nga rryma. Gjatë kësaj periudhe ai ka rezervuar disa surpriza për fansat, por kjo ka qenë mjaft pikante.

Bëhet fjalë për Kastro Zizon, i cili pasi njoftoi për bashkëpunimin me Eneda Tarifën dhe Robert Berishën ka goditur sërish. Ai ka publikuar në 'Instastory', një foto mjaft intime. Këngëtarja shfaqet i shtrirë në shtrat me një femër të cilës nuk i duket fytyra. Ata qëndronin të dy të zhveshur, teksa shikojnë njëri-tjetrin. Kastro na ka treguar se është në një lidhje, por identitetin e saj e ka mbajtur sekret. Mesa duket shumë shpejt do ta zgjidhim edhe këtë enigmë!



## Bën jetë superluksoze, ja si i fiton paratë Morena Tarku

Ajo tashmë njihet për fotot e saj të veçanta ku shfaqet me veshje shumë të shtrenjta të trendeve të fundit. Njihet tashmë se

bukuroshja, Morena Tarku është ndër të famshmet shqiptare që bën jetë më luksoze. Ajo është zgjedhur 'Miss Univers Kosova' para disa viteve dhe që nga ajo kohë Morena ka tentuar disa profesione, por nuk është se i ka shkuar shumë mirë. Morena madje ka tentuar të bëhet edhe këngëtare, ndërsa nuk është shumë aktive as në atë profesion. Por, cili është burimi i parave dhe jetës së luksit të Morenës? Dihet se babai i saj e ka mbështetur modelen/këngëtarën, por nuk dihet nëse ai është ende 'financuesi' kryesor i jetës së luksit të Morenës.



## E dinit të vogël? Ja sa vjeç mbushi Viola Spiro në të vërtetë

Viola Spiro është padyshim një nga moderatoret më seksi të ekranit shqiptar dhe ndër femrat më të ndjekura në rrjetin social 'Instagram'. Postimet e saj gjithmonë marrin vëmendjen e fansave, të cilët nuk harrojnë ta komplimentojnë jo vetëm për pamjen, por edhe për punën e saj në ekran.



Ditën e sotme, nëpërmjet një fotoje në 'Instastory', Viola ka bërë të ditur se ka ditëlindjen. Megjithatë nuk duket fare, moderatorja ka lindur më 28 shtator të vitit 1988 dhe sot ka mbushur plot 30-vjeç. Por në të vërtetë s'duket aspak aq!



## 'Kim Kardashian të bën më të keqe', e pranon Arbana Osmani

Moderatorja e njohur e "Dua të të bëj të lumtur", Arbana Osmani, ka postuar në 'Instastory'-n e saj një artikull të prestigjiozes huffingtonpost.com. "Të ndjekësh 'Keeping Up With The Kardashians' mund të të bëjë njëri më të keq" është titulli intrigues i kësaj gazete, i cili ka në bazë një studim të fundit me disa grupmosha. Sipas studimit, ka rezultuar se ndjekja e programeve të tilla, që promovojnë jetën e luksit, pasurinë dhe jetën glamuroze, në të vërtetë i bën njerëzit më asociale, i bën ata ta shohin me tjetër sy realitetin, por edhe jetën e njerëzve më të varfër. Duke e postuar, Arbana e ka konfirmuar një studim të tillë, por mos e kërkoni më foton e saj, sepse e fshiu vetëm pas pak minutash. Arsyen nuk dimë ta themi, por nuk është shumë çudi që Arbana nuk e pëlqen Kim-in dhe as jetën që përpiqet të bëjë dhe t'ua dëshmojë ajo të gjithëve... Sepse nuk është luxi që të bën të pasur. Dhe ka të drejtë!

## Largohet nga muzika, Eliza Hoxha rrëfen më në fund arsyen

E dhe pse kanë kaluar plot 18 vite, të gjithë e kujtojmë këngëtares e hitit "Me ritëm do vallëzoj", Eliza Hoxha. Kjo ishte pikënisja e këngëtares nga Prishtina, që më vonë zëri i veçantë dhe hitet do ta rendisnin ndër më të mirat në vend. Por muzika e mirë nuk ishte e vetmja rrugë që Eliza ndoqi. Ajo, gjithashtu, iu përkushtua profesionit të saj arkitekturës. Pas studimeve Master në Belgjikë, ajo u kthye në Kosovë për të kontribuar në vendin e saj. Ajo ishte e ftuar në emisionin "Rudina" në Tv Klan ku rrëfeu se arsyeja përse braktisi këngën dhe zgjodhi arkitekturën ishte se pikturonte shumë mirë dhe situata e paqëndrueshme politike. "Arsyet se përse braktisa këngën dhe zgjodha arkitekturën ishin



sepse kam qenë vizatuese dhe piktoresh e mirë në kohën e shkollës fillore dhe të mesme. Dhe e dyta situata politike. Nuk kishte asnjë kuptim që unë të shkoja dhe të studioja muzikë, sepse e kisha lënë përgjysmë shkollën e muzikës. Arkitektura është ajo që më përbush, sepse lidhet me dimensionin socio-kulturor që unë e kam shumë të rëndësishëm. Më ka mbajtur mirë me veten dhe me kontekstin ku jetoj. Arkitektura vetë është profesion shumë i gjerë dhe më ka dhënë mundësi për të eksploruar edhe në fusha të tjera. Fokusi im kryesor ka qenë aspekti socio-kulturor në atë qytet. Gjërat që unë bëj i kam lidhur me profesionin që unë kam. Shtëpia që unë kam nuk është shtëpia ime e ëndrrave, nuk jam afruar te ëndrra ime. Në fakt, kjo shtëpi ka qenë shtëpi e nevojës, sepse pas kthimit nga Belgjika ka qenë e pamundur që unë të jetoj me prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes"-tha Eliza Hoxha.



## "Kapet mat", moderatori shqiptar shfaqet me vajzën misterioze në Dhërmi

Ai është padyshim një nga moderatorët më të dashur të ekranit shqiptar dhe jo vetëm. Drini Zeqo gjithnjë ka rënë në sy për fizikun e tij si një person i lakmuar nga vajzat. Por së fundmi ai është kapur mat në një nga plazhet e jugut me një vajzë simpatike. Drini është fotografuar në Dhërmi nga paparazët duke vëzhguar format e vajzës së veshur me bikini lejla. Nuk dihet cila është kjo vajzë që i ka marrë mendjen Drinit. Të jetë vërtetë e dashura?

Opinion i Ditës

# Kuptimi i ndryshimit në arsim ndihmon edhe digjitalizimin e tij

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

...të cilësisë së shkollimit. E mirëkuptoj atë kur thekson se "mësimdhënia duhet të mbështetet tek karakteristikat vetjake psiko-fizike (prirjet, talentet etj.) të secilit nxënës", se "mësimdhënia duhet të jetë krijuese dhe jo standarde e rrafshuare e aspak uniforme për tërësinë e klasës"; se "mësimdhënia, për të nxitur qëndrimin kritik të nxënësit, nuk duhet të jetë mekanike e rrafshuar që nxit të mësuarit pasiv, përmendësh". Më tej, pajtohem me të, kur pohon se "përplotësimi i tekstit fizik (të printuar) me burime digjitale pasurojnë, përmirësojnë dhe zgjerojnë fushat përkatëse"; se "materialele digjitale duhet të plotësojnë, pasurojnë dhe përditësojnë lëndën në fjalë në orën e mësimi dhe jashtë saj etj.". E mirëkuptoj edhe kur pohon se reforma për tekstin digjital "do të mbetet qysh në krye skematike... po të kihet parasysh mundësitë tona të pakta për 'botën digjitale'. Për më tepër, kur edhe vende si Franca, konceptin e digjitalizimit e përkthyen si burime shtesë në plotësim të tekstit të printuar". Në anën tjetër, unë mendoj se shumë nga çka konstatohet e kërkon prof. Rokaj, nuk lidhen me politikën arsimore që mbështet reformën në arsim, por kushtëzojnë objektivisht nga ndikimi i faktorëve të shumëllojshëm.

Dobësitë dhe mungesat që konstatohen në sistemin tonë arsimor, i ndeshim sot në shumë sisteme arsimore, në rajon e më gjerë. Ato, në masë të madhe, janë pasojë e ndikimit të faktorëve njohës, kurrikular, pedagogjik, shtoni këtu edhe ata ekonomikë. Studiuues dhe qendra kërkimore ndërkombëtare me prestigj argumentojnë se analiza, qoftë edhe për përdorimin efiikas të mjeteve digjitale në mësim, në kontekstin e reformë arsimore, ofron rekomandime me vlerë, kur shkohet shumë më të thellë, prej nga ku, ndoshta, mund të kuptojmë dhe mënjanojmë faktorët sfidues.

Në terma të përgjithshme, konstatohet se sistemet aktuale arsimore nuk janë në frekuencë sa e si duhet me "botën reale", ku teknologjitë (përfshirë këtu edhe ato digjitale) po e ndryshojnë dramatikisht mënyrën si jetojmë dhe punojmë. Kjo i ka bërë sistemet arsimore tradicionale, bazuar në kurrikulat e njësuar dhe mësimin në klasë, mbeturina të së kaluarës. Procesi mësimor dhe të nxënësve nuk janë transformuar në përmbajtje dhe në formë. Ata kanë mbetur të njëjtë dhe formimi i nxënësve vijon të bazohet ende të notat, jo në atë që bën i diplomuari (në kompetencat që ai ka ndërtaur dhe ushtron). Mësimdhënia (term ky që përdor dhe prof. Rokaj, por që i përshkruan modelevë mësimore të së djeshmes me mësimin në qendër), për më shumë se 100 vjet, ka mbetur e njëjtë; shkollimi vijon të bazohet në



mësimin në klasa dhe fjala e mësuesit. Qëllimi i këtij të fundit është të paraqesë dhe shpjegojë materialin e paracaktuar në kurrikulat e miratuara, të cilat përshkruajnë edhe standardet e mësimdhënies. Çka ka ndryshuar në organizimin e procesit mësimor dhe teknologjitë që përdoren janë mjetet që u shërbejnë praktikave të vjetruara mësimore. Në vend të tabelave të zeza dhe shkumës, mësuesit po përdorin tabelat inteligjente (smart board-et), projeksonet statike përmes projektorëve të varur në tavan, mësuesit i zëvendësojnë me prezantime kompjuterike-interaktive (computer-interactive presentations); ndërsa nxënësit, në vend të lapsit dhe letërës, po përdorin tastierat dhe procesuesit e fjalës (word processors). Sakaq, korniza dhe strategjitë e organizimit të procesit të nxënësve kanë mbetur të njëjta. Sintezën e gjendjes na e ofron mjaft bukur Bill Gates (2005) në fjalimin e tij në Samitin Kombëtar mbi Shkollat: "Shkollat tona u hartuan pesëdhjetë vjet më parë për të plotësuar nevojat e një epoke tjetër". Të gjitha elementet e logjikës së siste-

meve të sotme arsimore (çfarë, pse, si duhet zhvilluar mësimi?) i takojnë logjikës së erës industriale, e hartuar për t'u shërbyer nevojave të shoqërive të asaj kohe. Sa u takon teknologjive të reja digjitale që përdoren në arsim, ato vijojnë të shërbejnë strategjitë e vjetra të mësimdhënies. Mënyrat aktuale të organizimit të saj vijojnë të kufizojnë mundësinë e shfrytëzimit të potencialit të plotë të risive teknologjike. E thënë ndryshe, "edhe TIK-u, thjesht, trajtohet si 'zgjatim' i praktikave mësimore tradicionale dhe po përdoret për të plotësuar qëllimet e erës industriale. Ai po shërben, vetëm ose kryesisht, si mjet për të zbuluar dijet ekzistuese (p.sh., nga baza të ndryshme të dhënash ose nga interneti) dhe për t'i prezantuar ato përmes programeve Word dhe PowerPoint, videoe, multi-mediaje, web-faqe etj. Por të gjitha këto janë shkathtësi që i zhvillon 'shkolla e vjetër' dhe, si të tilla, ato bëjnë që nxënësit ta shohin veten kryesisht si spektatorë pasivë në lidhje me dijen. Ta shohin dijen si 'dicka jashtë tyre', që zhvillohet nga të tjerët

dhe veten e tyre pa asnjë rol për të lozur në lidhje me këtë dije - veçse 'ta konsumojnë atë' (J. Gilbert, 2009). Kjo qasje tradicionale e zbatuar në sistemet arsimore pesë dekadat e fundit - pohojnë studiuesit - do të sfidohet, kur të kuptohen thellë evolimet thelbësore që po jetësohen në botën e arsimi. Njëri prej tyre është evolimi paradigmatik nga bi-hovjerizmi drejt social-konstruktivizmit dhe kognitivizmit. Ai po zëvendëson kurrikulën që thekson gjithë sa u duhet mësuar nxënësve, me kurrikulën që shpreh qartë atë që pritet të arrijë subjekti që vetëpëron; po shndërron modelet transmetuese të dijeve në nxëniet interaktive bashkëpunuese; po thekson kërkimin e kuptimit të nxënësve, më shumë se trajtimin e përmbajtjeve formale që kuptohen me vështirësi vetëm nga një pjesë e nxënësve; po realizon shndërrimin e dijeve lëndore në njohuri të reja që nxënësi i ndërton vetë nëpërmjet veprimt/kërkimit real, aspak nga projektet e nisura kryesisht prej mësuesit; po zhvillon mënyra të larmishme me të cilat krijohet dhe komunikohen kup-

timet në botën e sotme (fjala e shkruar, grafika, tingujt, informacioni elektronik ose mediatiq, teknologjia e bazuar në Cloud, gërshtetimi i bioteknologjisë dhe teknologjisë së informacionit, hologrami etj.); po lehtëson lidhjet, ndërveprimet, marrëdhëniet mes sistemeve të ndryshme të dijeve dhe mënyrave të ndryshme të paraqitjes së saj; po thekson dallimet dhe larminë, jo qasjet uniforme që 'i përgatitin të gjithë me një kut'; po nxjerr në pah më shumë proceset se sa produktet. Reformat që jetësojnë këto evolime janë të ndërlikuara dhe kërkojnë shndërrime madhore në nivele të ndryshme të sistemit arsimor si dhe burime. Le të kujtojmë këtu se, edhe vendeve që po zbatojnë variante të caktuara të qasjeve të reja, u janë dashur të paktën 10 vite, kohë gjatë të cilës është studiuar gjendja dhe nevojat e sistemit, janë konsideruar arritjet dhe alternativat e ndryshme, janë hartuar aktet përkatëse ligjore, nënligjore dhe profesionale, është zhvilluar kurrikula e re, është reformuar sistemi i formimit dhe i zhvillimit profesional të mësuesve etj.

Në këto kontekste, edhe digjitalizimi në arsim do të ndihmojë, nëse do të mundësojë marrëdhënie/lidhje/ bashkëpunime (globale dhe lokale) që nevojiten për të zhvilluar dijet e reja (shkollat e reformuara do të jenë edhe prodhuese, jo vetëm konsumatore të dijeve), do të ofrojë mundësinë dhe burimet e duhura për kërkimin real të nxënësve dhe mësuesve, do t'i ndihmojë nxënësit ta shohin veten si krijues aktivë të njohurive të tyre, zotërues të një roli për të lozur dhe kontributit për të dhënë.

Arsye të tilla na detyrojnë, që përpara se të kërkim gjatë sa dëshirojmë për përmirësimin e sistemit dhe të shkollave tona, t'u kthehim bazave të sistemit arsimor dhe t'i shohim shkollat në dritën e asaj, që ato duhet të bëjnë për t'i përgatitur nxënësit për jetët që do të jetojnë; të pyesim veten dhe të gjejmë përgjigje se për çfarë janë shkollat, çfarë duam të nxënë nxënësit në to, përse dhe si do duhet ta nxënë këtë, çfarë duhet të bëjë shkolla kur nxënësit nuk nxënë etj. Kjo kërkon që t'i tejkalojmë mënyrat e të menduarit të "erës industriale" rreth sistemit arsimor dhe procesit mësimor-educativ. Ndryshimi themelor në mendësi është mundësi e vyer për të kuptuar dhe ndihmuar ndryshimin që po bëjmë në shkollat tona dhe përse e bëjmë atë. Por edhe për të kuptuar më mirë se reforma jonë arsimore është projektuar sipas përvojave bashkëkohore. Jo për të mbushur kokat e nxënësve me lloje të veçanta të dijeve ekzistuese, por për të zhvilluar kompetencat e tyre për të nxënë në mënyrë të pavarur, për të ndërtaur dhe zbatuar njohuri të reja, gjatë dhe jashtë procesit mësimor-educativ, të ndihmuar nga mësuesit dhe teknologjitë digjitale. Dhe unë besoj fort se ky proces, edhe pse tjetër i vështirë, po ecën në shtigjet e përvojave të mira, jo vetëm në qëllime, por edhe në situata ku zhvillohet nxënia.

Opinioni *i* Ditës

# Nënkomisari që na tregoi një përdhunim në grup

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

...e pistoletës mbi kokë. Historia e kësaj vaje të masakruar nga njerëz me pushtet politik nuk është vetëm halli dhe fatkeqësia e saj.

Ato janë turpi dhe nënshtrimi i mbarë shoqërisë.

Tani që dosja voluminoze e këtij krimi të shëmtuar po shpalolet orë pas ore, ne kemi mundësi të shikojmë një sistem të kalbur në çdo ingranazh të të cilit gjenden njerëz të përkulur dhe të nënshtruar.

Sepse Xhisiela u end më kot në disa dyer komisaratesh dhe të gjithë refuzonin t'ia merrnin denoncimin.

Sepse gjatë kalvarit të saj, që shoqërohej me rrëmbime, kërcënime dhe përdhunime të herëpashërshme, ajo u gjend përballë me shefa policie, që i thoshin me mospërfillje: "Ai që të rreh, të do".

Sepse ajo u ndesh me punonjës rëndi që duhet të mbanin anën e viktimit, por që paraqiteshin me krengjari si "miq familjeje" të xhelatit. Sepse "në ndihmë" të saj u thirr me urgjencë një avokat, - ai tani njihet me emër dhe mbiemër - , i cili e braktisi në mëshirë të fatit.

Sepse "për t'u kujdesur" për të ia behu një psikologe, që nuk vërejti as gjurmë dhune dhe as shenja traume.

Sepse kryeprokurorja e re, e dalë pas votimit të reformës në drejtësi, nuk ka bërë asnjë gjë kundër birit të një deputeti që e ka votuar si socialist zgjedhjen e saj të paligjshme.

Sepse gjoja-kolegët e mi gazetarë u kënaqën me një përgënjeshtim të ngjarjes, kur ajo u denoncua për herë të parë kë korrik, ndërsa tani Xhisielën e përdorën si mish për top, për të shpëtuar Tulant Ballën dhe Rahman Rahjen.


Sepse të gjitha shoqatat e mbrojtjes së grave, që të hidhen në fyt po the një fjalë më tepër për një deputete femër, nuk patën guxim të belbëzojnë për këtë krim të përbindshëm.

Sepse aktivistët e të drejtave të njeriut u bukosën nga frika e përballjes me kriminelët.

Kjo pra është ajo çka Xhisiela nxori në pah: stofi i një shoqërie që është dorëzuar përpara së keqes, që i ka humbur shpresat se ajo mund të luftohet, sidomos kur është e veshur me pushtet, që ka bërë paqe të turpshme me mendësinë: "Kur të vjen e keqja, hapi derën".

Rasti i saj, përtej dramës së rëndë personale, është tragjik, si simbol i këtij nënshtrimi të përgjithshëm. Pikërisht kundër kësaj zbythjeje të të tërëve e solli rasti të ngrirë një nënkomisari i zakonshëm, Emiliano Nuhu, i cili vendosi ta denoncojë krimin.

Natyrisht, unë nuk e di nëse qëllimet e tij ishin idealisht të pastra, apo pragmatikisht të kalkuluar.



As nuk mund të vë dorën në zjarr nëse ai është sjellë si një polic model, apo si një njeri që i është dashur të bëjë kompromise me të vërtetën për të përfutur mbrojtje politike. Por, pavarësisht nga këto, me duken çnjerëzore aludimet që e shohin si një njeri që do digjej nga vetingu, si të blerë me para, si militant partiak, apo si kandidat për azil në Europë. Para së gjithash, ai është njeriu që

na ndriçoi për ekzistencën e një krimi të tmerrshëm. Ai që një nga të paktët që theu kodin e heshtjes së bashkëjetesës me të keqen. Kjo është arsyeja se pse breshëritë mbi të janë edhe më të mëdha. Pasi ato nuk vijnë vetëm nga politikanët e prekur drejtpërdrejt. Ato shpërhapen edhe nga ajo pjesë e shoqërisë, që është mësuar me turpërimin, që ka humbur fibrën e

rezistencës, që i është nënshtruar këtij përdhunimi në grup, ku askush nuk ka të drejtën të flasë dhe të reagojë për krimet e "të paprekshmëve". Xhisiela është pasqyra ku një pjesë e madhe e kësaj shoqërie e sheh veten të njollësuar. Prandaj nuk është çudi që ajo të urrehet në heshtje, njësoj si denoncuesi i rastit të saj po linçohet publikisht.

## HOROSKOPI

### DASHI

Sot do të ndiheni në gjendje shumë të mirë shëndetësore. Nëse keni në plan të investoni, është dita e duhur, por bëni mirë të keshilloheni me personat përkatës. Mos e nxisni më shumë një konflikt me të cilin mund të përballeni. Sa i përket anës romantike, do të kaloni një ditë fantastike.

### DEMI

Do të kaloni plot momente argëtuese. Është një ditë e mirë për t'u takuar me disa persona, të cilët i shihni shumë rrallë. Puna juaj e lodhshme do të shpërblehet sot. Bëni kujdes me taksat dhe siguracionet. Me gjysmën tuaj do të kaloni momente shumë romantike, ku do të mbizotërojnë puthjet dhe përqafimet.

### BINJAKET

Do të fitoni mjaftueshëm të ardhura gjatë ditës së sotme, por edhe do të shpenzoni njëkohësisht. Miqtë dhe bashkëshorti/bashkëshortja juaj do t'ju bëjnë të ndiheni komodë pavarësisht një dite të lodhshme. Duhet të punoni për projekte, të cilat mund t'ju sjellin përfitime për një kohë të gjatë.

### GAFORJA

Bëni mirë të relaksoheni në mbrëmje. Rritja e të ardhurave do t'ju krijojë kushte për të bërë disa blerje të rëndësishme. Duke bashkëpunuar me të afërmit tuaj do të arrini synimet. Përpjekjet tuaja do të sjellin rezultate pozitive.

### LUANI

Nëse mundeni, shmangeni udhëtimin që keni në plan. Marrëdhënia me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj do të ndërlloket për shkak të orëve të tepërta në punë. Miqtë do përpiqen t'ju vijin në ndihmë, por nuk do të munden t'ju japin ndihmën e duhur.

### VIRGJERESHA

Do të kaloni momente të mrekullueshme me fëmijët tuaj. Ka gjasa të merrni një lajm të mirë që nuk do t'ju lumturtojë vetëm ju, por edhe familjarët tuaj. Do të vlerësoheni për besnikërinë dhe aftësinë për t'i realizuar punë deri në përfeksion.

### PESHORJA

Mbrëmja me miqtë tuaj do t'ju relaksojë. Një rritje e papritur e shpenzimeve do t'ju shqetësojë pamase. Nëse dikush ju afrohet vetëm për interes, shmangeni pasi do të ndikojë negativisht në ditën tuaj. Ka gjasa që disa prej jush të përfitojnë rritje roge.

### AKREPI

Përfshirja në aktivitete me shumë persona do t'ju argëtojë pamase, por njëkohësisht do të keni edhe rritje të shpenzimeve. Mos fantazoni dhe bëhuni më realist. Shpenzoni më shumë kohë me miqtë tuaj. Sa i përket anës romantike, nuk është dita e duhur.

### SHIGJETARI

Sot do t'ju duhet të ndërmerri një vendim të rëndësishëm, çfarë do t'ju bëjë të ndiheni shumë nervoz dhe të tensionuar. Ka gjasa të vlerësoheni nga shëfat tuaj. Sa i përket jetës bashkëshortore, mund të kaloni një ditë të mrekullueshme me pak përpjekje nga ana juaj.

### BRICJAPI

Është dita e duhur për t'i bërë gjërat ashtu si duhet dhe për tu ndjerë mirë. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para. Partnerja/partneri juaj do të tregohet mbështetës. Për ata që nuk kanë dikë në krah, ka gjasa të takojë personin që kanë pritur gjatë gjithë kësaj periudhe.

### UJORI

Përfshirja në aktivitete që iu falin kënaqësi, në mënyrë që të largoni tensionin që iu ka përfshirë. Eksploroni mundësitë për investime të reja, por mos u nxitni. Përfshirja në to vetëm pasi të jeni bindur dhe këshilluar me personat tuaj të besuar. Ka gjasa të nisni një romançë të re, por nuk do të zgjasë shumë.

### PESHQIT

Debatit me dikë do t'ju prishë humorin. Është dita e duhur për të biseduar me disa persona që kishit kohë pa komunikuar. Ka gjasa të takoni një mik të vjetër me të cilin do të kujtoni plot momente të bukura nga e kaluara.

**PRESIDENTI I PARTIZANIT**



**Demi bën ironi: Titulli është për ekipet e mëdha si Skënderbeu**

Presidenti i Partizanit, Gazment Demi, ishte në humor pas ndeshjes së fituar nga skuadra e tij ndaj Tiranës. Ai e ka cilësuar një fitore të merituar, por nuk ka kursyer edhe një batutë ndaj rivalëve. "Rendësi ka që ishte ndeshje e bukur, e luftuar nga të dyja palët.

Ekipi ynë fitoi, mendoj që fitoi me meritë. Ishte një fitore për vogëlushin Leo. Titulli? Është fillimi, çfarë ka lidhje titulli, titullin e kanë këto të mëdhenjtë, Skënderbeu... Premio? Premio kanë gjithmonë lojtarët", tha Demi para gazetarëve.

**PRESIDENTI I TIRANËS**



**Halili vë në diskutim trajnerin: Ze Maria, është shpejt të flasim**

Presidenti i Tiranës, Refik Halili, foli pas ndeshjes, ku nuk u pa aspak i qetë dhe aspak i lumtur. Në fjalën e tij, Halili tha: "Është e drejtë, keqardhje për këtë humbje. Shpresoja dhe besoja te skuadra, edhe pse jemi shumë të tensionuar, është një skuadër me gati 18 lojtarë formacioni. Po të shihnit jashtë, kishte lojtarë

që edhe mund të luajnë titullarë. Kontingjenti është i mjaftueshëm. Kjo ka qenë detyra ime, që të bëjmë një merkato me shumë kujdes bashkë bashkëpunëtorët e mi. Pati nuk deshi, shpresojmë të ndryshojë në të ardhmen. Ze Maria? Është shpejt të flasim". - u shpreh presidenti Halili.

Tirana nuk fiton prej 14 ndeshjesh, skuadra e Gegës parakalon përkohësisht Skënderbeun



Jeton Selimi

# Partizani sundon sërish, merr derbin dhe vendin e parë

## Goli i Esat Malës vulos triumfin e të kuqeve

Kryeqyteti është i kuq. Partizani vazhdon me serinë e fitoreve në derbi, teksa mposhti me rezultatin minimal 1-0 Tiranën në "Selman Stërmasi". Ky ishte derbi i 150 në historinë me tyre, ndërsa të kuqtë arritën suksesin e 14 radhazi. As Ze Maria nuk ia doli të rikthejë bardheblutë te suksesi, ku fitorja në derbi mungon që nga viti 2014. Ndeshja ishte mjaft e bukur me raste nga të dyja skuadrat, ndërsa emocionet më të mëdha i dhuruan tifozët, të cilët me koreografitë e tyre e fituan ndeshjen në shkallët e stadiumit. Në 10 minutat e para mungojnë rastet e rrezikshme, me skuadrat që njihen me lojën e njëra-tjetrës. Tirana regjistroi rastin e parë të rrezikshëm pas 12 minutash lojë. Pas një zbritjeje në sulm, Daja hedh një top në zonë për Hasanin, i cili arrin të devijojë topin, por nuk ka shënjestrën e duhur. Mesfushori humbi një shans të artë (12'). Miqtë përgjigjen dy minuta më vonë me Asanin pas një goditjeje dënimi,



por Lika grushton duke larguar rrezikon. Partizani rrezikon sërish. Asani jep një top të bukur për Mensah, por Turtulli shkakton faull dhe Jorgji nuk heziton,

duke i treguar kartonin e verdhë ndërsa akordon goditje dënimi për Partizanin (18'). Telushi është ai që provon me një gjuajtje të fortë, por sfera përfundon

pak mbi traversë (20'). Një minutë më vonë "Demat" kaluan në avantazh me anë të mesfushorit Mala, i cili shfrytëzoi në mënyrë prefekte krosin e Asanit nga

e djathta. Në këto minuta të kuqtë luajnë më mirë dhe Trashi është ai që provon sërish pas një goditjeje këndi (26'). Tirana ka një mundësi të mirë për të barazuar ndeshjen me anë të kapitenit Asion Daja, por mesfushori gjen në gatishmëri portierin Hoxha pas një aksioni të shpejtë në krahun e djathtë (30'). 4 minuta më vonë është sërish Tirana që rrezikon, por Hoxha del në kohë dhe grushton krosin e Dajës. Pavarësisht disa aksioneve të rrezikshme, pjesa e parë u mbyll me avantazhin minimal të Partizanit. Pjesa e dytë nisi me Tiranën në sulm, që rrezikoi pas një sulmi të shpejtë në krah, me Blazhevskin që hedh një top drejt zonës, por Hoxha pret pa problem (47'). Partizani reagon me Asanin,

i cili në një minutë tenton dy herën portën e Likës, por portieri pret pa vëshitëri me të kuqtë që shpërdoran. Tirana është më kërkuese në këto minuta, por mungojnë rastet e rrezikshme. Në të 66' Hila i afrohet golit pas një topi të kthyer në zonë gjatë një krosimit të Malës, por mesfushori nuk ka shënjestrën e duhur dhe sfera përfundon jashtë. Bardheblutë luajnë me dy sulmues, por Partizani mbrohet mirë dhe nuk lë hapësira. Ze Maria i luan të gjitha kartat, por asnjë prej tyre nuk jep reagimin që braziliani priste. Pavarësisht disa aksioneve të rrezikshme, në fund ndeshja u mbyll me fitoren e "Demave të Kuq", që po tregojnë rritje në çdo ndeshje.

**TRAJNERI I PARTIZANIT**

**Gega ruan profilin e ulët: Nuk jemi për kampion**

Trajneri i Partizanit, Skënder Gega u pa shumë i kënaqur me skuadrën e tij pas fitores në derbi kundër Tiranës. Trajneri i "Demave të Kuq" tha për mikrofonat e "Supersport" pas takimit: "Në shumë pika është e paevitueshme presioni apo interesimi. Janë dy klube legjendare, që janë rivalë në jetë. Në radhë të parë, dua të shpreh ngushëllim nëse më lejohet për ndarjen nga jeta të tifozit tonë, ishte shumë emocionuese. Dua të shpreh ngushëllime edhe në emër të ekipit! Mendoj

që Partizani ishte përgatitur për këtë mënyrë loje, u munduam të mos dalim nga vetvetja. Jemi munduar të mbajmë larg problemet e Trashit e Telushit, por ato ishin pikat tona kryesore që mund të na dëmtonin në çdo moment. Nuk mund të vazhdonin deri në fund. Ishim me fat që ishin në fushë deri në ato momente. Mund të bësh volum loje dhe nuk ka shumë gola. U munduam që t'i mbanim larg, u stërvitëm që të mos i jepnim rast të qarkullonim topin. Kishim një problem në krahun e majtë me

Malën që dilte para, aty na rrezikoi Tirana. Bajko ka pas thënë që në derbi mendonte për ndeshjen ndaj çdo kundërshtari. Ndaj përmenda Kastriotin e Kamzën. Ekipi po rritet, pretendimet janë tonat, por nuk mund të them se jemi për kampion, se është rrugë e gjatë. Skënderbeu nuk më intereson, dua të shoh si funksionon Teuta, ajo është ndeshja e radhës. Shpresoj të mos dëmtohem. Mendoj që të shoh e të lexoj ndeshjen e tyre", - përfundoi Gega.

**TRAJNERI I TIRANËS**


**Ze Maria: Partizani fitoi me vetëm një gjuajtje në portë**

Trajneri i Tiranës, Ze Maria tha pas humbjes në derbin kundër Partizanit se e ardhmja e tij është gjithmonë në rrezik dhe se skuadra e tij nuk e meritonte të fitonte, por as të humbte në atë mënyrë, që sipas tij, u mposhtën me vetëm një goditje në portë: "Fituan sepse shënuan në rastin e vetëm që patën. Ne patëm një shans para golit dhe nuk shënuam, mendoj se shënuam me të vetmin shans që kishin në ndeshje. Kështu është futboll. Siç e thashë para ndeshjes, pozicioni im

është gjithmonë në diskutim. Siç e dini, dy vite më parë ranë nga kategoria dhe nuk fituan në ndeshjet e para, nuk mendoj se është rezultati më i keq në histori. Por tani mbaroi kjo ndeshje, të shohim çfarë do të ndodhë. Sot nuk bëmë mirë, dua të jem i singërtë, nuk luajtëm mirë si në ndeshjet e tjera. Nuk e merituar të fitonim ndeshjen, por nuk e meritoni as të humbim, por ky është opinionimi im. Nuk di çfarë ndodh në Shqipëri! Sa herë humb Tirana, shkarkoni trajnerin. Nëse më

pyesni pas çdo ndeshjeje gjithmonë, unë përgjigjem njëllor. Sa herë humbet, jep gjithmonë në rrezik, ndaj është gjithmonë e njëjta. Duhet të mendojmë, analizojmë ndeshjen, të analizojmë gabimet. Për këtë flas unë. E di çfarë do të thotë derbi për tifozët, por pas ndeshjes nuk mund të bësh asgjë. Jemi stërvitur mirë këto ditë. Më vjen keq se pashë tifozët, fola me ta para ndeshjes, më vjen keq për rezultatin, do të mundohemi të bëjmë më të mirën që të japim atë që kerkojnë këtë vit".

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Gjysmë arkivi.
- Sikur janë në krye.
- Janë të drejtë në skuadër.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Ndërmarrje Montimi Kombëtare.
- Shkon kot në vreshitë.
- Janë gazetat si RD e ZP.
- Inicialet e Morricono-s.
- Shkroi Në kërkim të kohës së humbur.
- Pastaj në fund.
- Brody i Pianisti.
- Fillojnë një rubrikë.
- Skuadra merengue.
- Gjysma e mollës.
- Baudo anchorman.
- Është honi.
- Mbyllin shishe.
- Një dylutim.
- Ishte lumi i harresës.
- Ishte xhelozja e Olimpkit.

**VERTIKAL**

- Ai dhe ajo.
- Në hyrje të rrethit.
- Është trofe që fitohet.
- Një derby i Madonnina-s.
- Ndreq në kufij.
- Mbyllin kënde.
- Mund të jenë gjaku dhe kuzhine.
- Royh aktor
- Janë klasat që nuk takohen.
- Janë pasanikë.
- Munë të jenë republike.
- Rajone Civile Durrës.
- Kuron pa zë.
- Diftong në teori.
- Kur bie... nuk të le të shohësh.
- Një personazh i Dickens.
- Kompozoi Boccaccio.
- Të fundit në ditar.
- Stucion bimët dhe lulet.
- Franklin që qe këngëtare.
- Kufizojnë paktet.
- Qytet italian.
- Nuk ka shenjtore në desk top
- Stacion televiziv gjerman.
- Besim pa kufij.
- Ajri i Londrës.
- Loja me games.
- Fillojnë detyrën.
- Inicialt e Altman.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Jo të gjitha bëjnë mjalhtë.
- Janë skuadra.
- Janë principe
- Një pijë freskuese.
- Ashtu qoftë në kishë
- Mund të jetë një mbrëmje letrare.
- Gjysma e kishës.
- Janë europianët e BE.
- Diftong në teatër.
- Inicialet e Presley.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Mbyllin fushatat.
- Fillojnë një metodë.
- Ende është ndryshe.
- Mund të jenë 4 X 100 dhe 4 X 400.
- Një gjuhë që flitet edhe në Sri Lanka.
- Kshutu thirrje Marco Pantani.
- Është faqe ene

**VERTIKAL**


- Pret shumë fëmijë.
- Opera e Mascagni-t.
- Zyrë Informacioni Ndërkombëtare
- Tamam në fund
- Një dhjetë në vit
- Është i dashpirti.
- I bën edhe Agron Llakaj.
- Mbyll fjalinë
- Si e gjithë.
- Fillojnë tatëpjetën.
- Mund të jenë cigaresh.
- Jepet për hartim.
- Ka një prind me ngjyrë.
- Janë vendet adreuese.
- Ndërohen me zapping.
- Është nofkë
- Është "Çatia e botës"
- Mund të jenë zemërkau.
- Është hidrokarbur.
- Është kreu i bandës.
- Futen në prizë.
- Është vija e portës.
- Janë llojet e njerëzve.
- Si moral!
- Ka dy bigami.
- Fillojnë daljen.
- Sikur janë në krye.
- Inicialet e Klee piktor.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

	9		1	6					
4			9		3				
			5	4					
	4	7	3	6	1				
3							1		
8	6								7
9		2			5	8	3		
5	7					4			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	7	9	4	6	1	8	3	2
6	4	8	2	3	5	9	7	1
1	2	3	7	8	9	4	5	6
4	8	1	3	5	2	6	9	7
2	3	5	9	7	6	1	8	4
7	9	6	1	4	8	3	2	5
3	1	2	5	9	4	7	6	8
8	5	7	6	1	3	2	4	9
9	6	4	8	2	7	5	1	3

*Argëtim filozofik*

- Nëse ajo që kërkoni nuk është atje jashtë, atëherë është brenda jush - Helen Keller
- Arsyeja për të cilën flas aq shpesh me veten time është sepse, është i vetmi që i përlej përgjigjet e tij - George Carlin
- Jeta është një shëtitje. Shijojë sepse nuk ka biletë kthimi. - George Carlin
- Ai që pyet përse jeton, mund të zbulojë një mijë arsye pse - Friedrich Nietzsche

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

13	5	10	1	10	19	18	5	8	6	3	19	A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T		
10	13	2	A	3	T	12			3	4	18	14	D	I	A	B	E	T	I	D	E	T		
13		13		3	2	4	3	2	4	5	3		R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T	
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18		F	E	N	I	M	O	R	E	T	R		
7	1	4	6	15	5	10	3	5	3		8	4	F		E	K	O	N	O	M	I	A	D	
19	9		20	2	10	1	4		6	3	2		R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E	
1	11	6		17		2			1	10	15		A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B	
8	13	1		6	1	9		3	5	10	13	2	N	A	N	T	E	S	T	L	L	A	R	A
3	6	10	7	2		6		2	4	6	2	10	K	N	E		I	I	L	I	R	E	T	
18	10		4		5	13	6	14	6		11	1	I	B	A	N	A	K	A	E	T			
12	2	14	2	3		2	11	6		10	5	4	B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D	
6		8	14	1	3		17	2	20	5	3	5	E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

D	A	V	I	D	R	O	C	K	L	K	R	
E	M	E	R	K	E	A	S	E	A	N		
M	A	L	O	T	K	E	N	E	T	A	T	
I	N	N	I	M	R	O	M	A	N	E	T	
R	R	P	A	S	I	V	E	T				
M	O	K	A	S	I	N	A	I	D	E	M	
E	M	I	R	A	T	I	A	V	A	T	I	
S	T	A	N	E	A	T	O	M	I	K	N	
S	A	R	S	T	R	E	T	E	O	D		
A	R	A	S	E	M	I	K	O	R	E		
A	T	A	T	A	K	A	T	I	D	A	R	
H	S	T	A	R	S	I	R	T	A	R	I	
B	A	L	E	N	A	A	M	O	T	I		
E	N	K	A	G	A	I	U	M	A			
K	I	M	I	K	R	E	K	A	R	A	T	E
I	T	P	A	L	E	T	L	I	R	I	A	
M	A	T	P	E	T	A	L	E	T	M	R	
I	K	A	L	K	U	L	I	M	E	T	R	
M	U	L	E	R	M	E	T	A	L	E		
A	N	B	E	T	A	I	R	P	O	T		
N	A	I	F	P	I	E	I	D	E			
E	T	J	E	M	I	N	A	T	O	R	E	T
T	I	T	R	E	N	I	A	F	A	T	I	

**FJALËKRYQI (1)**



*Thënie të mërcura*

- Nëse nuk ju përlejnë gjërat atje ku jeni, ndërroni vendin, nuk jeni pemë - Jim Rohn
- Ditët e bukura nuk vijnë për t'ju gjetur. Ju duhet të shkoni t'i gjeni - Rumi
- Nëse është dikush që gjithmonë duhet të jetë pranë meje, ai është vetja ime. - Jorge Bucay
- Ajo që je flet vetë, dhe aq fort saqë nuk mund të dëgjoj një fjalë nga ato që thoni - Ralph Waldo Emerson

